



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 174/3 Prot

Durrës, më: 30.03.2026

V E N D I M

Nr. 43, datë 30.03. 2026

PËR

**"MIRATIMIN E PROJEKT - STRATEGJISË SË PROFILIZIMIT TË FAKULTETIT  
TË STUDIMEVE PROFESIONALE, PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT, 2025-  
2030"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Senatit Nr.174, datë 17.12.2025; të Vendimit të Rektoratit Nr.4, datë 02.02.2026 pika 4; referuar shkresës Nr. 576/4 prot., datë 10.03.2026 të Fakultetit të Studimeve Profesionale, si dhe referuar Vendimit të Rektoratit Nr. 5, datë 18.03.2026 pika 3, në mbledhjen e datës 30.03.2026, Senati Akademik,

. V E N D O S I:

1. Miratimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale, përmes ndërkombëtarizimit për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Administratori
  - Zv. Rektorët
  - Drejtuesit e Njësive Kryesore
  - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





---


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

**PROJEKT- STRATEGJIA E PROFILIZIMIT  
TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE  
PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT  
2025 – 2030**

*Durrës, Shkurt 2026*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE



**QËLLIMI I PARË I STRATEGJISË:** Ndryshimi i qëndrueshëm i FSP nëpërmjet integritit në Smart Campusin digjital dhe përdorimit të AI

- ☑ Rritja e mundësive për automatizimi i shërbimeve akademike dhe administrative
- ☑ Rritja e përdorimit të inteligjencës artificiale (AI)
- ☑ Shtimi i numrit të auditorëve smart për performancë



**QËLLIMI I DYTË I STRATEGJISË:** Ndërkombëtarizimi i arsimit dhe kërkimit shkencor në FSP

- ☑ Rritja e numrit të partneriteteve me universitete europiane
- ☑ Zhvillimi i programeve të përbashkëta Master
- ☑ Angazhimi në projekte si Horizon Europe dhe Erasmus+



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE



**QËLLIMI I TRETË I STRATEGJISË:** Fakulteti i Studimeve Profesionale  
si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të qytetit dhe rajonit të Durrësit

- ☐ Bashkëpunimi me Bashkinë dhe sektorin privat për projekte urbane
- ☐ Përfshirja aktive në transformimin socio-edukativ të Durrësit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

**Lista e Shkurtimeve**

|        |                                                                         |
|--------|-------------------------------------------------------------------------|
| AKKSHI | Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin                |
| AKAFPK | Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet   |
| AKPA   | Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë                           |
| AKR    | Agjencia Kombëtare për Rininë                                           |
| AKSHI  | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit                        |
| BE     | Bashkimi Evropian                                                       |
| IAL    | Institucion i Arsimit të Lartë                                          |
| KiE    | Këshilli i Evropës                                                      |
| KM     | Këshilli i Ministrave                                                   |
| MAS    | Ministria e Arsimit dhe Sporteve                                        |
| MEPJ   | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme                               |
| OJQ    | Organizata Jo-Qeveritare                                                |
| OZHQ   | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm                                  |
| PKIE   | Plani Kombëtar për Integrimin Evropian                                  |
| RASH   | Rrjeti Akademik Shqiptar                                                |
| RYCO   | Regional Youth Cooperation Office (Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor) |
| SKR    | Strategjia Kombëtare e Rinisë                                           |
| TIK    | Teknologjia e informacionit                                             |
| UAMD   | Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës                                 |
| FSP    | Fakulteti i Studimeve Profesionale                                      |



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

**Pasqyra e lëndës**

**1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik**

- 1.1. Lidhja e Strategjisë së Zhvillimit të UAMD me Misionin, Vlerat dhe Prioritetet Institucionale
- 1.2. Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Kuadrot Strategjike Ndërkombëtare për Arsimin dhe Kërkimin Shkencor
  - 1.2.1. Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs – Agenda 2030, OKB)
  - 1.2.2. Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Strategjinë e OKB-së për Rininë – “Youth 2030”
  - 1.2.3. Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Strategjia Evropiane për Rininë 2019–2027
  - 1.2.4. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) – Procesi i Bolonjës
  - 1.2.5. Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Horizon Europe 2021–2027
  - 1.2.6. Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Barazinë Gjinore si Prioritet Strategjik në UAMD

**2. Profilizimi i UAMD-së në kuadër të ndërkombëtarizimit**

- 2.1. Gjendja aktuale dhe profili i FSP në UAMD
- 2.2. Target Smart 2025-2030 për FSP

**3. Riorganizimi i programeve ekzistuese (Audit + Reformim kurrikule)**

- 3.1. Audit i viti akademik 2025-2026
- 3.2. Reformim Kurrikule

**4. Mekanizmat e ndërkombëtarizimit në FSP**

- 4.1. Joint & Double Degrees (qasje graduale)
- 4.2. Kurrikul fleksibël dhe modulare
- 4.3. Mobilitet virtual dhe projekte të përbashkëta online

**5. Roli i Akreditimit në Strategjinë e Zhvillimit të FSP-së**

**6. KPI për FSP (2025-2030) – të lidhura me UAMD**

- 6.1. KPI kryesorë (Indikatorët e performancës)
- 6.2. Profilizimi i FSP

**7. Ruajtja e qëndrueshmërisë së FSP dhe rritja nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar**

- 7.1. Metodologjia e hartimit të strategjisë në nivel fakulteti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- 7.2. Analiza SWOT për ruajtjen e qëndrueshmërisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale
- 7.3. Deklarata e vizionit të Fakultetit të Studimeve Profesionale
  - 7.3.1 Vizioni strategjik I Fakultetit të Studimeve Profesionale
  - 7.3.2 Misioni I Strategjië së zhvillimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale
  - 7.3.4 Parimet themelore të strategjisë së zhvillimit
  - 7.3.5 Shtyllat strategjike të Fakultetit të Studimeve Profesionale
  - 7.3.6 Transformimi digjital dhe qëndrueshmëria në formimin e profesionistëve
  - 7.3.7 Ndërkombëtarizimi I programeve dhe I kërkimit në edukim
  - 7.3.8 Angazhimi me komunitetin dhe zhvillimin rajonal
- 7.4. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit
  - 7.4.1 Ruajtja e qëndrueshmërisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale në rrjetin e universiteteve shqiptare dhe rritja përmes bashkëpunimit ndërkombëtar
- 8. Përfshirja e studentëve në jetën universitare kulturore, sportive dhe kërkimore shkencore**
- 9. Ruajtja e Zhvillimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me shkollat e mesme dhe komunitetin**
- 10. Kërkimi shkencor në FSP**
  - 10.1. Roli I kërkimi shkencor në profilizimin dhe ndërkombëtarizimin e FSP
  - 10.2. Vizioni dhe misioni I kërkimit shkencor në FSP
  - 10.3. Objektivat strategjik 2025-2030 për kërkimin dhe bashkëpunimit ndërkombëtar
    - 10.3.1 Forcimi I kapaciteteve kërkimore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar
    - 10.3.2 Struktura e brëndshme kërkimore në FSP
    - 10.3.3 Sigurimi dhe rritja e fondeve kërkimore
    - 10.3.4 Kontribut në indeksimin dhe reputacionin shkencor (revista & botime)
    - 10.3.5 Përmirësimi I rankimit dhe impaktit
    - 10.3.6 Rritja e cilësisë së kërkimit dhe kulturës akademike\
    - 10.3.7 Sistemi meritokratik dhe avancim akademik
  - 10.4. Mekanizmat kryesor të zbatimit në FSP
  - 10.5. KPI të matshëm (2025-2030)
  - 10.6. Fazat e zbatimit (të harmonizuara me UAMD)
  - 10.7. Monitorimi dhe rezultatet e pritshme
- 11. Përfshirja e FSP në projekte kërkimore shkencore**
  - 11.1. Strategjia dhe vizioni
  - 11.2. Përfshirja në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare
  - 11.3. Ndikimi I projekteve në zhvillimin e fakultetit
  - 11.4. Treguesit e suksesit (KPIs)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

11.5. Fazat e zbatimit

12. Rrjetëzimi akademik dhe potenciali gjeografik I FSP

13. Bashkëpunimi me Diasporën

14. Integrimi I Praktikave Profesionale dhe sistemit të Intership-it: Shtylla e formimit në FSP

15. Zhvillimi I Materplanit per një kampus bashkëkohor dhe modern

16. Plani për digjitalizim

17. Zhvillimi I Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrësn ë harmoni me Strategjinë e Qytetit të Durrësit, Rajonit e më gjërë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

## 1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP) është krahua operativ dhe i aplikuar i Universitetit Aleksandër Moisiu. Në një treg akademik global gjithnjë e më konkurrues, ndërkombëtarizimi nuk është më një opsion, por një domosdoshmëri për të siguruar përsosmëri akademike dhe punësim të të diplomuarve.

Kjo strategji synon ta pozicionojë FSP-në si një Qendër Ndërkombëtare për Profesionet Teknike, duke u përqendruar në krijimin e diplomave të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta në bashkëpunim të ngushtë me partnerë prestigjiozë në Bashkimin Evropian.

Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të tregut modern të punës, Fakulteti është strukturuar në katër shtylla akademike të specializuara, secila prej të cilave kontribuon në formimin e profesionistëve teknikë të nivelit të lartë:

Katër Departamentet e FSP-së janë:

**1. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore:** Ky departament i është kushtuar trajnimit të avancuar klinik dhe teknik në sektorin e kujdesit shëndetësor. Përmes praktikës profesionale dhe protokolleve ndërkombëtare, ai trajnon profesionistët e kujdesit shëndetësor për të vepruar sipas standardeve evropiane të përsosmërisë, duke lehtësuar njohjen e kualifikimeve dhe lëvizshmërinë profesionale në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe të kujdesit shëndetësor.

**2. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës:** Ky departament ofron 2 programe studimi profesionale 2-vjeçarë në Informatikë Praktike dhe Specialist Rrjetesh Kompjuterike. Programet profesional 2- vjeçar janë programe studimi bashkëkohor dhe shumë të kërkuar që synojnë të formojnë dhe të përgatisin specialistë të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shkencave kompjuterike. Departamenti zotëron kapacitetet e nevojshme për mësimdhënie, jonet në programet 2-vjeçarë profesionale, por edhe në programet Bachelor dhe Master që ofron Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Staf akademik i Departamentit të Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës kanë publikuar punimet shkencore në revista ndërkombëtare dhe i ka prezantuar ato në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Interesat kërkimore-shkencore i kanë konsoliduar në një sërë projektesh ndërkombëtare dhe kombëtare.

**3. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë :** Departamenti zhvillon veprimtari mësimore dhe kërkimore në fushën e shkencave inxhinierike dhe detare. Ai ka profil profesional dhe shkencor në mekanikë, elektrikë, hidroteknikë, ndërtim, transport, detari, efikasitet etj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

**4. Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën:** Motori i vërtetë metodologjik i fakultetit, ky departament mishëron thelbin e "të mësuarit duke bërë". Ai koordinon integrimin e teorisë akademike dhe përvojës së drejtpërdrejtë në terren, duke siguruar që çdo program arsimor të validohet nga stazhet dhe bashkëpunimet e drejtpërdrejta me botën e biznesit.

Bashkimi i këtyre katër departamenteve i lejon FSP-së të ofrojë një kurrikulë multidisiplinare dhe thellësisht të orientuar drejt karrierës. Kjo strukturë organike është baza themelore për tërheqjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe për të siguruar që studentët në Universitetin Aleksandër Moisiu të gëzojnë një rrugë të pakufizuar karriere.

FSP karakterizohet nga një fakultet i kualifikuar dhe i përkushtuar, i cili jo vetëm që jep njohuri teorike, por gjithashtu promovon kërkimin shkencor, inovacionin dhe praktikën profesionale. Infrastruktura dhe mjediset moderne, të pajisura me teknologji të përparuara, u ofrojnë studentëve një përvojë cilësore mësimore dhe kërkimore, duke i përgatitur ata të jenë konkurrues ndërkombëtarisht.

Një përparësi kyçe është profilizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike, me qëllim rritjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe integrimin e studentëve dhe stafit në rrjetet globale.

Kjo strategji synon të ruajë dhe përmirësojë qëndrueshmërinë e objektit në treg nëpërmjet rritjes së studentëve ndërkombëtarë, përfshirjes aktive të studentëve në aktivitete akademike, kulturore dhe sportive, si dhe forcimit të lidhjeve me komunitetin dhe institucionet publike.

Strategjia e Fakultetit është në përputhje të plotë me prioritetet e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027, si dhe me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, përfshirë Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Ajo gjithashtu harmonizohet me dokumentet strategjike të zhvillimit rajonal dhe me prioritetet e vetë universitetit në fushën e ndërkombëtarizimit.

Procesi i hartimit të strategjisë ka kaluar përmes një sërë konsultimesh me stafin akademik dhe administrativ të universitetit, përfaqësues të studentëve, alumni-t, si dhe partnerë të rëndësishëm nga pushteti vendor dhe partnerë ndërkombëtarë. Këto takime dhe sesione dëgjimore kanë ndihmuar në identifikimin e nevojave reale, pritshmërive dhe sfidave që ndikojnë në zhvillimin institucional të UAMD-së.

Fakulteti i Studimeve Profesionale angazhohet për të promovuar një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj ndërkombëtarizimit, duke garantuar mundësi të barabarta për studentët dhe stafin, duke forcuar përfshirjen sociale, ndryshimin gradual të praktikave mësimore dhe kërkimore drejt digjitalizimit, si dhe zhvillimin e kompetencave sociale dhe ndërkulturore.

Përmes kësaj strategjie, Fakulteti synon të forcojë rolin e tij si aktor kyç në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të vepruar në një kontekst global dhe për të kontribuar në modernizimin e sistemit arsimor dhe atë të shërbimeve në Shqipëri.

Strategjia ka një qasje të qartë për përfshirjen aktive të të rinjve, duke mbështetur mundësi të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

barabarta për të gjithë studentët dhe duke promovuar përfshirjen sociale, digjitalizimin, praktikat profesionale dhe pjesëmarrjen qytetare.

### 1.1 Lidhja e Strategjisë Zhvillimit të FSP me Misionin, Vlerat dhe Prioritetet Institucionale

Strategjia e ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP) është një komponent integral i vizionit të përgjithshëm të universitetit, që synon rritjen e bashkëpunimit akademik, mobilitetit dhe konsolidimin e standardeve ndërkombëtare në ciklet e studimit profesional, bachelor dhe master profesional. Përmes këtij orientimi, fakulteti angazhohet për rritjen e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit në kuadër të programit Erasmus+, krijimin e marrëveshjeve bilaterale me universitete partnere në Evropë e rajon, si dhe mundësimin e praktikave profesionale jashtë vendit për të forcuar kompetencat teknike të studentëve. Kjo strategji mbështetet në partneritete strategjike me institucione profesionale evropiane për projekte të përbashkëta kërkimore-aplikative dhe përfshirjen në rrjete akademike prestigjioze, duke garantuar një rritje të cilësisë sipas standardeve evropiane dhe harmonizimin e kurrikulave me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF) përmes sistemit ECTS dhe ekspertizës së huaj në sigurimin e cilësisë. Ndërkombëtarizimi i kurrikulës realizohet përmes integritetit të literaturës bashkëkohore, ofrimit të lëndëve në gjuhën angleze dhe ftesës së lektorëve të huaj, elementë që rrisin dukshmërinë ndërkombëtare të FSP-së në konferenca, forume dhe publikime të indeksuara. I ndërtuar në përputhje të plotë me misionin institucional për një zhvillim të qëndrueshëm dhe socialisht të përgjegjshëm, Fakulteti i Studimeve Profesionale pozicionohet si një njësi akademike aktive me fokus të qartë drejt tregut të punës vendas dhe ndërkombëtar. Oferta akademike, e cila përfshin programe 2-vjeçare, bachelor dhe master profesional, është e orientuar drejt formimit praktik dhe përgatitjes së specialistëve të lartë në fusha prioritare si shëndetësia, shkencat inxhinierike dhe teknologjia e informacionit, duke u dhënë studentëve aftësitë e duhura për të operuar në një mjedis ekonomik që transformohet vazhdimisht nga digjitalizimi dhe automatizimi.

Në përputhje me misionin e universitetit për të qenë një institucion i angazhuar, ndërkombëtar dhe socialisht i përgjegjshëm, **Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP)** angazhohet të zhvillohet si një njësi akademike me orientim të qartë drejt tregut të punës dhe standardeve ndërkombëtare, duke integruar praktikat më të mira evropiane në kurrikula, kërkim të aplikuar dhe formim profesional.

Oferta akademike e Fakultetit përfshin programe studimi kryesisht në ciklet **2-vjeçare profesionale, bachelor dhe master profesional/shkencor**. Këto programe synojnë përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve të aftë për të operuar në një mjedis ekonomik në transformim të vazhdueshëm, të ndikuar nga digjitalizimi, automatizimi dhe zhvillimet teknologjike.

Oferta akademike e Fakultetit të Studimeve Profesionale është e orientuar drejt formimit praktik dhe profesional, duke përgatitur specialistë të mesëm dhe të lartë në fusha prioritare të ekonomisë, shëndetësisë, shkencave inxhinierike dhe shkencave të aplikuara në fushën e teknologjisë së informacionit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

Profilizimi i Fakultetit do të mbështetet në:

- Ndërkombëtarizimin e formimit profesional dhe teknik;
- Integrimin e kompetencave digjitale dhe aftësive praktike të aplikuara;
- Zhvillimin e kërkimit shkencor të aplikuar me dimension krahasues dhe evropian.

Fakulteti karakterizohet nga një staf akademik dhe ndihmës-akademik i kualifikuar, i cili kontribuon jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në inovacionin teknik dhe bashkëpunimin e ngushtë me sipërmarrjet dhe industrinë. Në kuadër të profilizimit përmes ndërkombëtarizimit, prioritet do të jetë rritja e pjesëmarrjes së stafit në projekte ndërkombëtare (si Erasmus+), publikime në revista teknike të indeksuara dhe rrjete akademike profesionale evropiane.

Duke operuar në një mjedis ekonomik gjithnjë e më të ndërlidhur, Fakulteti i Studimeve Profesionale synon të forcojë rolin e tij si një **qendër moderne e ekselencës praktike**, që promovon përfshirjen sociale dhe zhvillimin e kompetencave për një karrierë të suksesshme në kontekstin evropian. Përmes ndërkombëtarizimit, Fakulteti do të:

- Rrisë mobilitetin e studentëve për praktika profesionale jashtë vendit;
- Zhvillojë partneritete strategjike me fakultete homologe dhe kompani lider në Evropë;
- Ofrojë lëndë dhe module teknike në gjuhë të huaj;
- Krijojë mundësi për programe të përbashkëta dhe diploma të dyfishta (Double Degree), përveç programit aktual Joint Master of Science in Maritime Environmental Protection and Management.

Synimet afatgjata të Fakultetit janë të konsolidojë pozicionin e tij si një njësi akademike lider në fushën e **studimeve profesionale në nivel rajonal**, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së fuqisë punëtore shqiptare. Strategjia e zhvillimit do të mbështetet në:

- Rritjen e cilësisë akademike dhe praktike në formimin e specialistëve;
- Forcimin e lidhjeve me **biznesin, industrinë dhe institucionet publike**;
- Promovimin e kërkimit inovativ dhe zgjidhjeve teknike për industrinë;
- Adoptimin e teknologjive digjitale dhe laboratorëve të fjalës së fundit.

Një prioritet i veçantë do të jetë profilizimi ndërkombëtar i programeve, përmes harmonizimit me **Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF)**, duke siguruar që diplomat tona të njihen dhe të jenë konkurruese ndërkombëtarisht. Fakulteti synon të rrisë numrin e studentëve të huaj, të organizojë seminare profesionale ndërkombëtare dhe të forcojë dimensionin kërkimor përmes projekteve të financuara nga BE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

Në këtë kuadër, FSP do të zhvillohet në harmoni me prioritetet e zhvillimit të Durrësit dhe rajonit, duke ofruar ekspertizë akademike dhe trajnime profesionale që i përgjigjen nevojave të tregut. **Digjitalizimi i proceseve, përdorimi i platformave ndërkombëtare dhe krijimi i laboratorëve profesionalë bashkëkohorë** do të përbëjnë elementët kyç të këtij transformimi.

**Objektivi final** është që Fakulteti i Studimeve Profesionale të njihet si një institucion modern dhe i qëndrueshëm, i orientuar drejt inovacionit teknologjik dhe rritjes së standardeve profesionale në Shqipëri dhe më gjerë.

## 1.2 Lidhja e Strategjisë së FSP- së me Kuadrin Strategjik Ndërkombëtar për Arsimin dhe Kërkimin Shkencor

Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale për periudhën **2025–2030** ndërtohet në përputhje të plotë me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e **arsimit profesional, inovacionit teknologjik dhe kualifikimit teknik**, duke reflektuar orientimin strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës drejt ndërkombëtarizimit, digjitalizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Fakulteti synon të konsolidojë profilin e tij akademik përmes integritit të dimensionit ndërkombëtar në kurrikula dhe bashkëpunimet e ngushta institucionale me sektorin privat. Kjo arrihet duke respektuar drejtimitet strategjike të institucioneve evropiane dhe globale që udhëheqin **formimin profesional (VET)** dhe zhvillimin e kompetencave teknike të nivelit të lartë:

### 1.2.1 Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs Agenda 2030 OKB)

Në përputhje me Agjendën Globale 2030, Fakulteti i Studimeve Profesionale kontribuon drejtpërdrejt në disa prej objektivave kryesore:

**SDG 4 – Arsimi cilësor:** Formimi i teknikëve, specialistëve dhe profesionistëve të kualifikuar, zhvillimi i kurrikulave praktike bashkëkohore dhe promovimi i praktikave laboratorike gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në standarde teknike.

**SDG 5 – Barazia gjinore:** Integrimi i perspektivës gjinore në programet e studimeve teknike, kërkimin e aplikuar dhe praktikat institucionale, si dhe promovimi i rolit të grave në teknologji dhe udhëheqje profesionale.

**SDG 8 – Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike:** Përgatitja e profesionistëve të aftë për tregun e punës, përmes praktikave profesionale në ndërmarrje, bashkëpunimit me industrinë dhe zhvillimit të kompetencave teknike për punën në epokën digjitale.

**SDG 9 – Inovacion dhe infrastrukturë:** Zhvillimi i laboratorëve teknikë, përveç funksionit didaktik, duhet të kthehen edhe në realizimin e shërbimeve dhe ekspertizave për pale të treta në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përdorimi i teknologjive të avancuara në mësimdhënien praktike, si dhe integrimi i metodave inovative në formimin e specialistëve dhe teknikëve të lartë.

**SDG 13 – Veprim për klimën:** Promovimi i teknikave të qëndrueshme të prodhimit e





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

shërbimit dhe përfshirja e tematikave të eficiencës energjetike e mjedisore në kurrikulat profesionale dhe projektet teknike.

**SDG 16 – Institucione të forta dhe përfshirëse:** Forcimi i kulturës së transparencës, etikës profesionale dhe pjesëmarrjes studentore në vendimmarrjen akademike dhe administrative.

**SDG 17 – Partneritete për qëllimet:** Zhvillimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare me fakultete teknike homologe, rrjete profesionale dhe institucione ekonomike evropiane.

### **1.2.2 Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Strategjinë e OKB-së për Rininë "Youth 2030"**

Duke e konsideruar Fakultetin e Studimeve Profesionale si një hapësirë kyçe për formimin e specialistëve të rinj dhe profesionistëve të fushave teknike, strategjia synon të sigurojë:

- mundësi të barabarta për zhvillim teknik dhe profesional;
- pjesëmarrje aktive të studentëve në projekte të aplikuara dhe iniciativa ndërkombëtare;
- zhvillimin e kompetencave profesionale dhe digjitale.

Në këtë kuadër, Strategjia synon të promovojë të rinjtë si aktorë të zhvillimit dhe kontribues në zbatimin e OZHQ-ve, në përputhje me parimet e strategjisë globale të OKB-së për rininë.

### **1.2.3 Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027.**

FSP mbështet parimet e kësaj strategjie përmes

- promovimin e mobilitetit të studentëve dhe stafit përmes programeve si Erasmus+;
- zhvillimin e moduleve me përmbajtje ndërkombëtare dhe literaturë bashkëkohore;
- përfshirjen e studentëve në aktivitete akademike me dimension evropian;
- nxitjen e inovacionit teknologjik dhe sipërmarrjes profesionale në industri.

### **1.2.4 Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) - Proçesi i Bolonjës**

Strategjia e Fakultetit mbështetet në:

- sistemin e kreditimit ECTS dhe modularizimin e kurrikulave;
- harmonizimi me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve;
- forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane;
- sigurimi i cilësisë akademike përmes AKKSHI
- promovimin e diplomave të njohura ndërkombëtarisht;
- rritjen e mobilitetit të stafit dhe studentëve si tregues i ndërkombëtarizimit real.

### **1.2.5 Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Horizon Europe 2021-2027**

Si pjesë e profilizimit përmes ndërkombëtarizimit, Fakulteti synon:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- rritjen e kapaciteteve për aplikime në programet e kërkimit të Bashkimit Evropian;
- ndërtimin e rrjeteve ndërkombëtare kërkimore në fushën e **teknologjisë dhe shkencave të aplikuara**;
- përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte që adresojnë sfida bashkëkohore të **industrisë** (digjitalizimi, **automatizimi**, eficienta energjitike, energji të rinovueshme, **inovacioni profesional**);
- rritjen e publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtarisht.

#### **1.2.6 Lidhja e Strategjisë së FSP-së me Barazinë Gjinore si Prioritet Strategjik në UAMD**

Në përputhje me dokumentet kombëtare dhe evropiane për barazinë gjinore, Fakulteti i Studimeve Profesionale e konsideron integrimin gjinor si parim themelor të zhvillimit institucional.

Në nivel fakulteti, masat synojnë:

- garantimin e mundësive të barabarta për studentë dhe staf nga të gjitha grupet shoqërore;
- përfaqësim të barabartë në strukturat vendimmarrëse dhe projektet kërkimore;
- parandalimin e çdo forme diskriminimi dhe dhune me bazë gjinore;
- integrimin e perspektivës gjinore në kurrikula dhe kërkim shkencor;
- krijimin e një ambienti akademik të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

Përmes kësaj qasjeje, Fakulteti i Studimeve Profesionale synon të konsolidojë një kulturë institucionale që promovon drejtësinë sociale, barazinë dhe respektin, duke përgatitur profesionistë të aftë që reflektojnë këto vlera në praktikën e tyre teknike dhe profesionale

## **2. Profilizimi i FSP-së në kuadër të ndërkombëtarizimit**

### **2.1 Gjendja aktuale dhe profili i FSP në UAMD**

Fakulteti i Studimeve Profesionale është një nga shtyllat kryesore të UAMD-së, me rol qendror në përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve të fushave teknike dhe të zbatuara (navigacion, informatikë e aplikuar, specialist rrjetesh kompjuterike, menaxhim transporti, infermieri, fizioterapi, teknikë laborator, hoteleri-turizëm, mekanikë, teknik elektrik, menaxhim ndërtimi, hidroteknik, specialist të sistemeve të kondicionimit). Aktualisht, ndërkombëtarizimi në UAMD është ende i përqendruar kryesisht në programe double degree të cilat ofrohen në gjuhën shqipe dhe dy ose tre lëndë në gjuhë të huaj, ndërsa për FSP ndërkombëtarizimi duhet të shtrihet në mënyrë të strukturuar: përmes programeve në gjuhë të huaj, moduleve në anglisht, partneriteteve Joint/Double, mikrokrediteve dhe mobilitetit profesional.

**Pozicionimi strategjik i FSP në kuadër të ndërkombëtarizimit:**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

- FSP si "hub" për teknologji moderne, laboratorë digjitalë, inxhinieri të aplikuar, shërbime profesionale dhe logjistikë, me orientim drejt standardeve evropiane (ECTS, certifikime profesionale, mobilitet).
- FSP si "qendër shërbimi" për universitetin dhe komunitetin: trajnime teknike dhe profesionale për industrinë, përgatitje e specialistëve të kualifikuar, trajnime të stafit teknik, kurse të gjuhës teknike, mikrokredite për profesionistë, module ndërkulturore dhe metodologji të kërkimit të aplikuar.

## 2.2 Target SMART 2025–2030 për FSP

Duke u bazuar në targetin e UAMD: "50% programe me  $\geq 20\%$  mësim në anglisht dhe marrëveshje bashkë-diplomimi/dual deri 2030", FSP e përkthen në objektiva të matshëm:

### SMART 1 (Programe / Module):

Deri në 2027, FSP të ketë të paktën 3 program të ofruar në gjuhë të huaj (ose program i ri, ose track/variant në anglisht brenda një programi ekzistues).

### SMART 2 (Partneritete Joint/Double):

Deri në 2027, FSP të ketë 5 marrëveshje Joint/Double Degree (Bachelor ose Master Profesional) me universitetet dhe kolegjet teknike partnere.

### SMART 3 (Mikrokredite & Edukim në Vazhdim):

Deri në 2027, të zhvillohen 4 module me mikrokredite në temat: teknologji digjitale të aplikuara, siguri në punë, menaxhim teknik hibrid, etikë profesionale & AI në industri. Deri në 2030, të ofrohen 12+ module me mikrokredite dhe të jenë të transferueshme drejt Masterit Profesional/Shkencor/Bachelor (në përputhje me modelin e UAMD për lifelong learning).

### SMART 4 (Studentë & Mobilitet):

Deri në 2030, FSP të arrijë 10% studentë ndërkombëtarë (nga shkëmbime semestrale për praktika profesionale, programe të përbashkëta, summer schools teknike, blended modules)..

## 3. Riorganizimi i programeve ekzistuese (Audit + Reformim kurrikule)

Në përputhje me strategjinë e UAMD, FSP realizon riorganizimin në 3 hapa:

### 3.1 Audit viti akademik (2025–2026)

- **Analizë e programeve aktuale të FSP** me fokus: përputhje me standardet e certifikimeve profesionale evropiane, rezultatet e të nxënësve tekniko-praktik (learning outcomes), komponentin e praktikës intensive në laboratorë dhe industri, si dhe kërkimin e aplikuar.
- Identifikim i lëndëve me literaturë ndërkombëtare të pasur dhe interes për studentë të huaj:  
p.sh. **Navigacion dhe Menaxhim Detar:** Maritime English, Celestial Navigation, Ship Stability, Marine Engineering Basics; **Shëndetësi:** Nursing Care Concepts, Medical Techniques, Emergency Care, Clinical Pathology; **Menaxhim & Shërbime:**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

Hospitality Management, Logistics & Supply Chain, Tourism Marketing, Applied Economics.

### **3.2 Reformim kurrikule (2026–2030)**

- **Shtim i moduleve në anglisht:** Fillimisht 2–3 lëndë teknike në çdo program (si p.sh. "Technical English for IT" ose "Maritime Law") si pilot për shkëmbimet Erasmus+.
- **Futje e moduleve ndërkulturore dhe rregullatore:** "International Technical Standards (ISO)", "Global Logistics & Trade", "Intercultural Communication in Tourism & Hospitality".
- **Integrim i moduleve teknologjike & ndërdisiplinore:** "AI in Applied Sciences", "Digital Twin Technology", "Smart Systems Maintenance", "Industrial Cyber Security".
- **Përgatitje e personelit akademik dhe stafit ndihmës akademik:** Trajnime specifike për mësimdhënie në laboratorë në gjuhën angleze dhe përdorim i manualeve teknike ndërkombëtare.

## **4. Mekanizmat e ndërkombëtarizimit në FSP**

### **4.1 Joint & Double Degrees (qasje graduale)**

- Pilot 1 program test (2026–2027), psh: Master Profesional: "Logistics Management / Digital Technology" ose tjetër me partner evropian.
- Standardizim i modelit të marrëveshjeve: përafrim kurrikulash teknike, njohje kreditesh ECTS, rregulla mobiliteti për praktika, standarde të vlerësimit profesional.
- Krijim i Komisionit Ad Hoc FSP për Joint/Double (2026): monitorim tekniko-shkencor, koordinim, procedura administrative, cilësi.

### **4.2 Kurrikul fleksibël dhe modulare**

- Ristrukturim i programeve në module standarde me ECTS (core + elective).
- Hapje e moduleve të FSP për studentë nga fakultete të tjera (aftësi praktike) dhe për studentë incoming.
- Paketim i "minor tracks" (p.sh. *Digital Technology Minor*, *Applied Management Minor*).
- Platformë digjitale për zgjedhje moduli + monitorim progresi (në linjë me "Digital Campus").

### **4.3 Mobilitet virtual dhe projekte të përbashkëta online**

- COIL (Collaborative Online International Learning): projekte online me universitete partnere në lëndë të FSP.

Javë ndërkulturore, leksione të hapura, workshope metodologjie kërkimi me ekspertë të huaj.

## **5. Roli i Akreditimit në Strategjinë e Zhvillimit të FSP-së**

Përfshirja e akreditimit si komponent strategjik synon të sigurojë që FSP jo vetëm të përmbushë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

detyrimet ligjore dhe standartet kombëtare, por të ndërtojë një kulturë të brendshme të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Objektivi kryesor është që të gjitha programet e studimit të ndjekin ciklin ligjor të vlerësimit dhe akreditimit në përputhshmëri me Standartet e Cilësisë së Arsimit të Lartë në Shqipëri.

**a. Garanci për Cilësinë Akademike**

Akreditimi siguron që programet e studimit përmbushin standartet kombëtare të cilësisë, duke krijuar bazën ligjore dhe institucionale për vlerësim të jashtëm dhe përmirësim të vazhdueshëm. Procesi i akreditimit nxit zhvillimin dhe rishikimin periodik të kurrikulave, forcimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe rritjen e kapaciteteve kërkimore, në përputhje me kërkesat e raporteve të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

**b. Ndërkombëtarizimi dhe Sigurimi i Cilësisë**

Programet me diploma të përbashkëta, të dyfishta apo shumëfishe duhet të sigurojnë përputhshmërinë me parimet e ESG-së dhe standartet që kërkohen nga partnerët ndërkombëtarë. Akreditimi kombëtar, si proces i detyrueshëm ligjor, garanton besueshmëri institucionale në marrëveshjet ndërkombëtare.

**c. Transparencë dhe Besueshmëri për Studentët dhe Partnerët**

Akreditimi institucional dhe i programeve rrit transparencën ndaj studentëve dhe garanton cilësinë e diplomave të lëshuara, duke krijuar siguri në tregun e punës dhe në institucionet akademike brenda dhe jashtë vendit.

Masat Strategjike për Akreditimin në kuadër të Planit afatgjatë 2030-2040

| Qëllimi                                                             | Veprimet kryesore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Rritja e numrit të programeve të akredituara                        | <ul style="list-style-type: none"><li>- Proces i vetëvlerësimit të brendshëm të programeve për akreditim.</li><li>- Hartimi dhe rishikimi i kurrikulave në përputhje me standartet kombëtare, duke u orientuar nga parimet e ESG për sigurimin e cilësisë.</li><li>- Organizimi i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ mbi menaxhimin e cilësisë dhe proceset e akreditimit</li></ul> |
| Integrimi i procesit të akreditimit në planifikimin akademik të FSP | <ul style="list-style-type: none"><li>- Akreditimi mbetet mekanizëm i detyrueshëm i sigurimit të cilësisë, i cili zbatohet për të gjitha programet e studimit, në përputhje me fazën e zhvillimit të programit dhe afatet ligjore.</li><li>- Krijimi i një kalendari të brendshëm për rivlerësime periodike të programeve.</li></ul>                                                              |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

|                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Zhvillimi i programeve ndërkombëtare dhe sigurimi i cilësisë së tyre | <ul style="list-style-type: none"><li>- Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë për vlerësimin dhe, kur është e nevojshme, akreditimin e përbashkët të programeve të dyfishta/shumëfishe.</li><li>- Përdorimi i ekspertizës ndërkombëtare për hartimin dhe harmonizimin e dokumentacionit.</li><li>- Vlerësimi rast pas rasti i nevojës për akreditim ndërkombëtar në funksion të objektivave strategjike dhe natyrës së programit.</li></ul> |
|----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

## 6. KPI për FSP (2025–2030) – të lidhura me UAMD

### 6.1 KPI kryesorë (Indikatorët e Performancës):

- **% e programeve të FSP me  $\geq 20\%$  module në anglisht:** Targeti 50% e programeve (sidomos në degët e Navigacionit dhe Turizmit) deri në vitin 2030.
- **Programe në gjuhë të huaj:** Minimum 1 program i plotë profesional ose teknik (Bachelor ose Master Profesional) deri në vitin 2027.
- **Marrëveshje Joint/Double:** 5 marrëveshje pilot me kolegje teknike ose universitete profesionale evropiane deri në 2027; rritje në 8 marrëveshje deri në 2030.
- **Mikrokredite të ofruara:** 4 module me mikrokredite në fushën e certifikimeve teknike dhe profesionale deri në 2027; 12+ module deri në 2030.
- **Staf i trajnuar për gjuhë teknike/akademike dhe laboratorë digjitalë:** Targeti 60% e stafit akademik dhe ndihmës-akademik deri në vitin 2030.
- **Studentë incoming/outgoing + mobilitet virtual:** Rritje vjetore e matshme, me fokus te praktikat profesionale (internships) jashtë vendit.
- **Module ndërkulturore/ndërdisciplinore të integruara:** Rritje progresive e lëndëve që lidhin teknologjinë me standardet ndërkombëtare të industrisë.

### 6.2 Profilizimi i FSP-së

Fakulteti i Studimeve Profesionale është ndër më të rëndësishmit, me një rol të madh në përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve të fushave teknike mjekësore, shkencave të aplikuara dhe të natyrës, në fushat e inxhinjeris së mjedisit, menaxhimit detar, teknologjia automobilash dhe juridike e administrative. **Departamenti i Shkencave Inxhenierike dhe** është njësi akademike bazë që zhvillon veprimtari mësimore dhe kërkimore në fushën e mekanikës, në fushën elektrike, të ndërtimit, hidroteknikës, atë mjedisore si edhe navigacionit. Ai integron formimin teorik me praktikat profesionale, duke përgatitur specialist të aftë në sektorin e mekanikës së automjeteve, makinerive industrial, infrastrukturës, energjitikës, mjedisit dhe industrisë detare dhe logjistike. DSHID mbështet kërkimin shkencor të orientuar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

drejt zgjidhjeve teknike dhe të qëndrueshme duke bashkëpunuar me industrinë për transferimin e njohurive dhe inovacionit. Përmes laboratoreve dhe projekteve ndërkombëtare Erasmus + dhe Interreg kontribuon në zhvillimin teknologjik dhe ekonomik të rajonit. **Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore** mbulon fushën e infermierisë, fizioterapisë dhe teknikës mjekësore, duke i ofruar studentëve njohuri mbi praktikat klinike dhe diagnostikuese e jo vetëm. **Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës** kontribuon në formimin profesional 2-vjeçarë në Informatikë Praktike dhe Specialist Rrjetesh Kompjuterike. Programet profesional 2-vjeçar janë programe studimi bashkëkohor dhe shumë të kërkuar që synojnë të formojnë dhe të përgatisin specialistë të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shkencave kompjuterike me orientim praktik. **Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën** merret me përgatitjen e specialistëve të turizmit, hotelierisë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, asistent ligjor e administrativ sipas metodave bashkëkohore të shërbimit.

FSP synon që deri në vitin 2030 të forcojë profilin e tij ndërkombëtar duke zhvilluar programe të përbashkëta, diploma të dyfishta dhe module të ofruara në gjuhë të huaja. Strategjia pesëvjeçare 2025–2030 fokusohet te konsolidimi i departamenteve sipas fushave të tyre dhe orientimi drejt një vizioni të qartë të ndërkombëtarizimit, duke integruar njëkohësisht përdorimin e inteligjencës artificiale, simulimeve online dhe teknologjive moderne laboratorike, në përputhje me drejtimet e Bashkimit Europian për formimin digjital. Ky vizion afatgjatë përfshin tri faza kryesore: konsolidimin (2025–2030), zgjerimin (2030–2035) dhe inovacionin e integruar (2035–2040). Fakulteti i Studimeve Profesionale do të mbetet bërthama e formimit teknik, por i orientuar më fort drejt kompetencave praktike, për të formësuar specialistë aktiv dhe të aftë për të përballuar nevojat dhe kërkesat e një tregu pune që zhvillohet.

#### 7. Ruajtja e qëndrueshmërisë së FSP-së dhe rritja nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar

Strategjia e Fakultetit të Studimeve Profesionale është mbështetur në premisën se formimi i specialistëve dhe profesionistëve teknikë kërkon përshtatje të vazhdueshme ndaj zhvillimeve teknologjike, industriale, ekonomike e bashkëkohore në perspektivë. Në një klimë konkurruese kombëtare dhe ndërkombëtare, Fakulteti synon të luajë rolin e një qendre rajonale cilësore në shkencat e aplikuara dhe formimin profesional, duke forcuar partneritetet aktuale me institucione të huaja të arsimit të lartë, duke krijuar bashkëpunime të reja me institucione të ngjashme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, organizata ndërkombëtare me prirje teknike dhe shkencore, si dhe duke krijuar rrjete akademike në fushën e teknologjisë dhe kërkimit të aplikuar.

Krijimi i një mjedisi akademik gjithëpërfshirës, ku studentët të ndihen bashkëkrijues të procesit mësimor, praktikës profesionale në laboratorë dhe kërkimit shkencor, përbën një shtyllë themelore të zhvillimit të Fakultetit. Forcimi i lidhjeve me sipërmarrjet, industrinë dhe komunitetin lokal është pjesë integrale e vizionit për të dhënë kontributin e duhur për përmirësimin e cilësisë së fuqisë punëtore në Shqipëri dhe për zhvillimin socio-ekonomik të qytetit, të rajonit e më gjerë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

### 7.1 Metodologjia e hartimit të strategjisë në nivel fakulteti

Për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale për periudhën 2025–2030, në përputhje me orientimet institucionale të universitetit, është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, e bazuar në analizën e detajuar të strategjisë së UAMD dhe përshtatjes së saj me kushtet e FSP duke synuar rritjen progresive të Fakultetit në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe procesit të ndërkombëtarizimit.

Procesi hartimit të strategjisë është bazuar në punën dhe analizën e grupit të punës ngritur me Urdhër Dekani, për zbërthimin e strategjisë së UAMD, në ekspertizën dhe profesionalizmin e anëtarëve të grupit me përfaqësi nga çdo departament i Fakultetit të Studimeve Profesionale, si dhe në përdorimit të instrumenteve analitike dhe përkthimit në objektiva strategjike.

### 7.2. Analiza *SWOT* për ruajtjen e qëndrueshmërisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale

Në vijim të strategjisë së zhvillimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë akademike, institucionale dhe financiare për **Fakultetin e Studimeve Profesionale** është realizuar analiza SWOT, me qëllim identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në performancën dhe perspektivën e tij zhvillimore për të ardhmen, si një ndër fakultetet e UAMD-së me fokus të lartë drejt tregut të punës dhe teknologjisë.

#### Pikat e Forta

- Krijimi i një tradite në formimin teknik dhe profesional, me një përvojë të suksesshme në kualifikimin e specialistëve të lartë në navigacion, shëndetësi, teknologji dhe menaxhim, asistent ligjor e administrativ.
- Staf akademik i kualifikuar me formim shkencor dhe praktik në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Laboraret janë një tjetër pike e fort. Aktualisht Laboratori I Eficiencës është I vetmi që ka pajisje të certifikuara. Laboratori i MEP&M është I vetmi laborator me pajisje distance learning në UAMD.
- Ofrim i një programi UNIK në UAMD Joint Master in Maritime Environmental Protection and Management në gjuhën angleze. Është i vetmi program master shkencor në UAMD që ka diplomë TË PËRBASHKËT.
- Bashkëpunim i konsoliduar me administratën shtetërore, spitalet, portet dhe sipërmarrjet private për zhvillimin e praktikave profesionale intensive.
- Përshtatje e shpejtë e kurrikulave me nevojat e tregut rajonal dhe kombëtar.
- Mbështetje institucionale për pajisjen me laboratorë specifikë dhe procesin e ndërkombëtarizimit teknik.
- Përfshirje e studentëve në projekte aplikative dhe aktivitete që lidhen me inovacionin teknologjik.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- Zhvillimi i "Blue Economy" (Ekonomisë Blu) dhe turizmit, që rrit kërkesën për programet e FSP. (DSHID është leader në projektin ZERO C dhe DecarBOATS)

#### **Dobësitë**

- Kosto e lartë për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pandërprerë të laboratorëve teknologjikë dhe pajisjeve mjekësore.
- Mungesë e programeve teknike të ofruara plotësisht në gjuhë të huaj (përveç moduleve specifike).
- Nevoja për më shumë programe të përbashkëta (Joint Degrees) me kolegje profesionale evropiane.
- Vështirësi në angazhimin e studentëve në kërkim shkencor të mirëfilltë, për shkak të fokusit kryesisht praktik.
- Domosdoshmëri për forcimin e sigurimit të cilësisë në monitorimin e praktikave jashtë institucionit.
- Nevoja për rritjen e kapaciteteve akomoduese për studentët që vijnë për programe profesionale specifike.

#### **Mundësitë**

- Kërkesa në rritje e tregut të punës për teknikë dhe specialistë të lartë të certifikuar (sidomos në IT, Navigacion, Menaxhim dhe Shëndetësi).
- Mundësi financimi nga BE (Erasmus+, Horizon, projekte për inovacionin) për modernizimin e laboratorëve dhe teknologjisë.
- Rritja e interesit të maturantëve për programe 2-vjeçare dhe bachelor që garantojnë punësim të shpejtë.
- Zhvillimi i "Blue Economy" (Ekonomisë Blu) dhe turizmit, që rrit kërkesën për programet e FSP.
- Hapja e mikrokrediteve për certifikime profesionale të kërkuara nga biznesi.
- Strategji për diploma të dyfishta me universitete teknike në rajon dhe BE (p.sh. Itali, Gjermani).
- Integrimi i Inteligjencës Artificiale në proceset teknike dhe shërbimet mjekësore.

#### **Kërcënimet**

- Emigrimi i forcës punëtore të kualifikuar (specialistëve) menjëherë pas diplomimit.
- Konkurrenca nga qendrat private të trajnimit profesional dhe certifikimit të shpejtë.
- Ndryshimet e shpejta teknologjike që mund t'i bëjnë pajisjet laboratorike të vjetruara në një kohë të shkurtër.
- Varësia nga politikat sektoriale (shëndetësore, detare, transporti) dhe ndryshimi i kriterëve të licencimit profesional.
- Rreziku i mospërputhjes së shpejtësisë së kurrikulës akademike me dinamikën e industrisë private.

#### **7.3 Deklarata e Vizionit të Fakultetit të Studimeve Profesionale**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

### 7.3.1 Vizioni Strategjik i Fakultetit të Studimeve Profesionale

Në përputhje me misionin dhe orientimin strategjik të Universitetit, Fakulteti i Studimeve Profesionale synon të jetë një njësi akademike themelore në përgatitjen e specialistëve të lartë, teknikanëve dhe profesionistëve të fushave të aplikuara, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin cilësor të industrisë, sistemit shëndetësor dhe atij të shërbimeve në nivel kombëtar, por dhe rajonal.

Vizioni i Fakultetit të Studimeve Profesionale në të ardhmen do të jetë: Një fakultet bashkëkohor, inovativ dhe gjithëpërfshirës, që formon lundërtarë, infermierë, fizioterapist, specialistë të teknologjisë së informacionit, menaxherë shërbimesh dhe teknikë të kualifikuar me formim shkencor cilësor dhe me integritet etik, kompetenca digjitale si dhe aftësi praktike për t'iu përgjigjur sfidave të tregut të punës dhe shoqërisë në shekullin XXI.

### 7.3.2 Misioni i Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale

Misioni i Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale është të garantojë cilësi të lartë në formimin bazë dhe të vazhdueshëm të specialistëve të lartë dhe profesionistëve të fushave teknike e shërbimeve, mbështetur në zhvillimet shkencore dhe teknologjike bashkëkohore të vendit dhe të universiteteve në rajon e më gjerë; të zhvillojë më tej kërkimin e aplikuar në fushën e teknologjisë dhe shkencave profesionale, si dhe të japë ndihmesën e tij në përmirësimin e praktikave laboratorike dhe industriale në tregun e punës shqiptar dhe më gjerë.

Fakulteti synon të krijojë një mjedis akademik gjithëpërfshirës, që mbështet zhvillimin profesional e shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, nxit mendimin kritik, etikën profesionale dhe kulturën e inovacionit teknologjik në mësimdhënien praktike dhe në fushën e kërkimit të aplikuar.

### 7.3.4 Parimet Themelore të Strategjisë së Zhvillimit

Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale mbështetet në këto parime themelore:

- **Cilësi dhe profesionalizëm** në formimin e specialistëve të lartë dhe profesionistëve të fushave teknike e shërbimeve përmes programeve të studimit të harmonizuara me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të industrisë.
- **Qasje gjithëpërfshirëse dhe barazi** në formimin profesional duke promovuar gjithëpërfshirjen dhe duke i dhënë vlerën e duhur konceptit të "diversitetit" në të gjitha nivelet e kualifikimit teknik.
- **Integrim i teorisë me praktikën** përmes praktikave profesionale intensive në laboratorë, partneriteteve me industrinë, biznesin dhe institucionet publike e private.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- **Kërkim i aplikuar dhe inovacion teknologjik** me fokus në përmirësimin e proceseve teknike dhe metodave të punës në bashkëpunim me zhvillimet teknologjike bashkëkohore.
- **Digjitalizim dhe zhvillim i kompetencave teknologjike** për përgatitjen e profesionistëve për mjedise të avancuara pune, automatizimi dhe sisteme hibride, si një kërkesë e të tashmes dhe e së ardhmes në tregun e punës.
- **Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm** për të garantuar cilësi teknike, transparencë, përgjegjëshmëri dhe përmirësim të qëndrueshëm të standardeve institucionale.

Në këtë kuadër, Fakulteti i Studimeve Profesionale synon të konsolidohet si një institucion universitar bosht në fushën e shkencave të aplikuara për formimin e profesionistëve, duke vendosur në qendër studentin, cilësinë e aftësive praktike dhe përgjegjësinë profesionale e shoqërore.

### **7.3.5 Shtyllat Strategjike të Fakultetit të Studimeve Profesionale**

Vizioni i Fakultetit të Studimeve Profesionale do të realizohet duke u mbështetur në tri shtylla bosht apo strategji të cilat do ta kthejnë këtë fakultet në një institucion kyç të arsimit të lartë dhe në një pikë refence në fushën teknike, inxhinierike, detare, menaxhimit në hoteleri turizëm apo ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, specialist rrjetesh kompjuterike, asistent ligjor e administrativ për institucione të së njëjtës natyrë brenda vendit, në rajon, por edhe më gjerë të cilat janë:

- I. Transformimi digjital dhe qëndrueshmëria në formimin profesionistëve
- II. Ndërkombëtarizimi i programeve dhe i kërkimit në edukim
- III. Bashkëpunimi i ngushtë me industrinë, bizneset dhe zhvillimi rajonal

### **7.3.6 Transformimi digjital dhe qëndrueshmëria në formimin e profesionistëve.**

Qëllimet:

- Automatizimi i shërbimeve akademike dhe administrative për stafin akademik dhe studentët.
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI) dhe të internetit të Pajisjeve (IoT) në mësimdhënie dhe menaxhimin institucional.

Objektivat:

- Krijimi i një strukture të digjitalizuar nëpërmjet automatizimit të proceseve administrative (regjistrimi i studentëve on-line, menaxhimi i provimeve, komunikimin me studentët dhe arkivimin digjital).
- Digjitalizimi i materialeve mësimore mësuara në natyrën dhe tipologjinë e lëndëve.
- Përgatitja e studentëve për përdorimin e platformave digjitale, inteligjencës artificiale dhe mjeteve interaktive në funksion të procesit të të nxënës.
- Promovimi i edukimit për zhvillim të qëndrueshëm teoriko-praktik dhe në progres, mbështetur në përdorimin e mjeteve digjitale.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

**7.3.7 Ndërkombëtarizimi i programeve dhe i kërkimit në fushtat teknike mjekësore, inxhinierike, detare, menaxhimit etj**

**Qëllimet:**

- Politika për rritjen e numrit të partneriteteve strategjike me universitetet evropiane
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta në nivelin e dytë dhe të tretë të studimeve
- Përfshirja në projekte të Bashkimit Evropian (Erasmus + dhe Horizon Europe)
- Përfshirja e studentëve të huaj dhe e stafit akademik ndërkombëtar.

**Objektivat:**

- Krijimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit dhe partneriteteve strategjike me universitete evropiane dhe ndërkombëtare.
- Krijimi i programeve të përbashkëta të studimit prej njësive bazë të fakultetit me universitete partnere evropiane.
- Rritja e numrit të aplikimeve dhe pjesëmarrjes në programe, si: Erasmus + dhe Horizon Europe, por edhe në projekte të tjera brenda vendit, në rajon e më gjerë.
- Publikime shkencore në revista të indeksuara dhe projekte të përbashkëta me partnerë të huaj.
- Rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të programeve ndërkombëtare (Erasmus+, projekte kërkimore etj.)
- Pjesëmarrja aktive në konferenca dhe rrjete kërkimore ndërkombëtare në fushën e edukimit.
- Publikime shkencore në revista të indeksuara dhe projekte të përbashkëta me partnerë të huaj.

**7.3.8 Angazhimi me komunitetin dhe zhvillimi rajonal**

**Qëllimet:**

- Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe sistemin arsimor. Forcimi i bashkëpunimit me administratën publike, sipërmarrjet private, hotelet, spitalet publike apo private si dhe organizatat e shoqërisë civile për zhvillimin e projekteve arsimore, sociale dhe komunitare që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies, bashkëpunimin dhe ndikimin e mjedisit universitar të FSP-së në komunitet.
- Nxitja e iniciativave studentore në fushat e navigacionit, teknikët mjekësor, teknik automobilash, asistent ligjor dhe administrativ, specialist rrjetesh kompjuterike etj. Mbështetja e projekteve dhe iniciativave studentore që synojnë inovacionin në mësimdhënie dhe mësimnxënie, krijimi i një qasjeje me zhvillim progresiv në kërkimin shkencor, si dhe përfshirja në edukimin komunitar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

#### 7.4 Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit

Për të siguruar zbatimin efektiv të strategjisë Fakulteti i Studimeve Profesionale do të zbatojë një plan të rregullt monitorimi dhe vlerësimi i cili do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi ecurinë e çdo veprimtarie dhe indikatorët përkatës (KPI).
- Anketa me studentët, stafin dhe aktorë të jashtëm për të vlerësuar ndikimin.
- Rishikimin e strategjisë çdo dy vite për përshtatje me zhvillimet e reja.
- Përdorimin e një paneli treguesish për krahasime me universitetet homologe.

Ky sistem do të garantojë transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm.

##### 7.4.1 Ruajtja e qëndrueshmërisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale në rrjetin e universiteteve shqiptare dhe rritja përmes bashkëpunimit ndërkombëtar

Të sigurohet një pozicionim i qëndrueshëm dhe konkurrues i Fakultetit të Studimeve Profesionale në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë profesional, përmes ndërkombëtarizimit të programeve teknike, rritjes së mobilitetit akademik dhe zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e shkencave të aplikuara dhe kërkimit teknologjik.

##### Objektivat Specifikë

- **Hartimi i politikave** për përfshirjen e studentëve ndërkombëtarë në programe të lidhura me lundrimin, shëndetësinë, teknologjinë dhe menaxhimin profesional.
- **Më shumë programe studimi në gjuhë të huaj**, kryesisht në anglisht, në nivelet Bachelor dhe Master Profesional (p.sh. *Maritime English-taught modules*).
- **Thellimi i partneriteteve** ndërkombëtare akademike dhe bashkëpunimi me qendra të ekselencës profesionale dhe industriale jashtë vendit.
- **Zhvillimi i një infrastrukture laboratorike dhe administrative** mbështetëse për studentët ndërkombëtarë, me qëllim integrimin e tyre praktik dhe social.
- **Ofrimi i moduleve teknike në gjuhën shqipe** për studentë të huaj (si pjesë e shkëmbimeve kulturore-teknike), si element promovues i ekspertizës sonë rajonale.

##### Nisma të Propozuara

- **Zhvillimi i fushatave promovuese** ndërkombëtare të orientuara drejt programeve profesionale, me fokus vendet e rajonit e më gjerë që kërkojnë specialistë të certifikuar.
- **Nënshkrimi i marrëveshjeve** për programe të përbashkëta (*double/joint degrees*) me universitete teknike dhe kolegje profesionale strategjike në Evropë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

- **Hartimi dhe akreditimi i programeve Bachelor/Master** në gjuhën angleze, në fushat e navigacionit dhe menaxhimit të shërbimeve.
- **Forcimi i strukturave institucionale** për mbështetjen e studentëve ndërkombëtarë, përmes një sistemi të integruar mentorimi teknik dhe orientimi profesional.

**Indikatorë të Matshëm (KPI) 2025–2030**

- **Rritje vjetore** e numrit të studentëve ndërkombëtarë të regjistruar në FSP (përfshirë shkëmbimet për praktika semestrale).
- **Programe studimi teknike** në gjuhën angleze të akredituara deri në vitin 2030.
- **Shtim i marrëveshjeve ndërkombëtare** me fokus njohjen e ndërsjelltë të krediteve praktike dhe licencave profesionale.
- **Përmirësimi i nivelit të rankimeve** ndërkombëtare përmes certifikimeve të cilësisë (si p.sh. standardet ISO ose IMO për navigacionin)

**8. Pëfshirja e studentëve në jetën universitare kulturore, sportive dhe kërkimore shkencore**

**Qëllimi Strategjik:**

Të zhvillohet një mjedis universitar gjithëpërfshirës, ku studentët angazhohen përtej auditorit, në aktivitete që nxisin kreativitetin, mirëqenien, shprehjen dhe kontributin në komunitet.

**Objektivat specifike:**

- Zhvillimi i aktiviteteve të rregullta kulturore dhe artistike;
- Nxitja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete sportive dhe klube të organizuara;
- Angazhimi i studentëve në projekte kërkimore dhe aplikative.

**Nisma të propozuara:**

- Krijimi dhe mbështetja e klubeve studentore (shkencore, kulturore, sportive, etj.);
- Organizimi i aktivitete të larmishme studentore çdo semestër;
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore të drejtuara nga stafi akademik (përmes moduleve si praktikë ose punë e kursit);
- Mbështetje me infrastrukturë (biblioteka, salla trajnimi, qendra sporti, etj.).

**Indikatorë të matshëm (KPI):**

- Të paktën 1 aktivitet studentor në çdo muaj;
- Rritje vjetore 10% e studentëve të përfshirë në aktivitete jashtë-mësimore;
- Shtim i numrit të studentëve që marrin pjesë në kërkime dhe publikime;
- Nxitja, themelimi dhe mbështetja e klubeve të reja studentore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

## 9. Ruajtja e Zhvillimit i marrëdhënieve të qëndrueshme me shkollat e mesme dhe komunitetin

### Qëllimi Strategjik:

Të forcohen lidhjet e Fakultetit me industrinë, institucionet shëndetësore, autoritetet portuale, sipërmarrjet teknologjike dhe komunitetin lokal/rajonale, duke ndikuar në orientimin e të rinjve drejt profesioneve teknike dhe duke konsoliduar rolin e FSP si një aktor aktiv në zhvillimin ekonomik.

### Objektivat specifike:

- Ndërtimi i urave të komunikimit të vazhdueshëm me bizneset dhe institucionet partnere për praktikën dhe punësimin;
- Rritja e njohjes së FSP si qendër e ekselencës teknike në komunitetet lokale dhe rajonale;
- Zhvillimi i rolit këshillues dhe teknik të FSP në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

### Nisma të propozuara:

- Krijimi i një **Kalendari Vjetor të Vizitave** në industrinë e interesit, porte, spitale dhe kompani IT, në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe mësuesit e karrierës në shkollat profesionale;
- Realizimi i ditëve të hapura ("**Open Labs**") në FSP, ku nxënësit e shkollave të mesme të shohin nga afër laboratorët e navigacionit, infermierisë dhe teknologjisë;
- Bashkëpunim me bashkitë dhe bizneset për projekte teknike, mjedisore, shëndetësore dhe inovative për rininë;
- Promovimi i programeve të studimit përmes platformave digjitale, videove demonstruese të punës praktike dhe prezantimeve në shkolla teknike e profesionale

### Indikatorë të matshëm (KPI):

- Shtim i përvitshëm i numrit të institucioneve shtetërore dhe sipërmarrjeve private;
- Shtim i përvitshëm i numrit të pjesëmarrësve në "Open Labs" në FSP;
- Rritje e aplikimeve nga maturantët që kanë marrë pjesë në aktivitete të FSP;
- Aplikim të përvitshme për projekte komunitare.

## 10. Kërkimi shkencor në FSP

### 10.1 Roli i kërkimit shkencor në profilizimin dhe ndërkombëtarizimin e FSP

Në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UAMD-së dhe ndërkombëtarizimit, kërkimi shkencor në Fakultetin e Studimeve Profesionale është shtylla që lidh drejtpërdrejt:





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- **cilësinë akademike** (kurrikula të bazuara në evidencë teknike, laboratorë të avancuar);
- **ndërkombëtarizimin** (bashkëpunime kërkimore-teknike, publikime me bashkautorësi ndërkombëtare, projekte të përbashkëta aplikative);
- **rankimin institucional** (publikime në revista teknike Scopus/WoS, citime, ndikim në industrinë e specializuar);
- **ndikimin në komunitet** (standarde shëndetësore, siguri lundrimi, eficiencë teknologjike, zhvillim profesional i specialistëve).

FSP-UAMD duhet të pozicionohet si një fakultet që prodhon kërkim të aplikueshëm në sektorët e shërbimeve dhe industrisë: automatizim, teknika mjekësore, menaxhim logjistik, digjitalizim industrial, navigacion modern, ekonomi blu dhe politika të zhvillimit profesional.

## **10.2 Vizioni dhe misioni i kërkimit shkencor në FSP**

### **Vizioni:**

Të afirmohet si një qendër reference në Shqipëri dhe rajon për kërkimin në teknika mjekësore, menaxhim logjistik, digjitalizim industrial, navigacion modern, ekonomi blu dhe politika të zhvillimit profesional dhe në integrimin evropian të praktikave akademike.

### **Misioni:**

Të zhvillojë kërkim cilësor, të qëndrueshëm dhe ndërkombëtar, të lidhur me nevojat reale të sistemit arsimor dhe komunitetit, përmes:

- grupeve kërkimore dhe laboratorëve tematikë,
- publikimeve në revista të indeksuara,
- partneriteteve dhe projekteve me universitete të huaja,
- transferimit të rezultateve në politika dhe praktikë (schools/community impact).

## **10.3 Objektivat strategjikë 2025–2030 për kërkimin në FSP**

### **10.3.1 Forcimi i kapaciteteve kërkimore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar**

- Krijimi i grupeve kërkimore të FSP (interdisiplinore) dhe lidhja e tyre me partnerë ndërkombëtarë (sidomos partnerët e programeve të dyfishta/joint).
- Rritja e publikimeve me bashkautorësi ndërkombëtare, si indikator direkt i ndërkombëtarizimit.

### **10.3.2 Strukturë e brendshme kërkimore në FSP**

Në linjë me Institutin Kërkimor Ndërdisiplinor të UAMD-së, FSP organizon kapacitetet e veta si:

**Njësia e Kërkimit të Aplikuar (FSP Research Unit):** koordinim temash teknike, thirrje të brendshme për projekte laboratorike, mentorim, etikë profesionale, menaxhim i të dhënave teknike.

#### **Klasterë kërkimorë tematikë (shembuj):**

- **Teknologjitë Digjitale & AI në Industri:** Automatizim, sisteme inteligjente dhe siguri kibernetike.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- **Shkenca Mjekësore & Shëndet Publik:** Protokolle të reja infermierore, teknika diagnostikuese dhe menaxhim shëndetësor.
- **Navigacion & Ekonomi Blu:** Siguria detare, logjistika portuale dhe menaxhimi i transportit detar.
- **Inovacion në Shërbime & Turizëm:** Hoteleri-turizëm, menaxhim i qëndrueshëm i shërbimeve dhe sipërmarrje profesionale.
- **Inxhinieri e Aplikuar & Energji:** Eficienca energjitike, energjitë e rinovueshme, mirëmbajtja mekanike dhe teknologjitë e gjelbra

#### **10.3.3 Sigurimi dhe rritja e fondeve kërkimore**

- Rritje graduale e financimeve për kërkimin brenda FSP për: mini-grante, konferenca, publikime, vizita kërkimore.
- Diversifikim i burimeve përmes:
  - Erasmus+ (KA2/CBHE, Partnerships),
  - Horizon Europe (kur FE lidhet me tema si "Digital Education", "Inclusion", "Mental Health", "Societal Resilience" etj.),
  - bashkëpunime me institucione publike (MAS, DAR/ZA, bashki),
  - partneritete me sektorin privat (edtech, testim, trajnime).

#### **10.3.4 Kontribut në indeksimin dhe reputacionin shkencor (revista & botime)**

FSP ka rol kyç në forcimin e botimeve të UAMD-së:

- rritje e artikujve me autorë ndërkombëtarë,
- nxitje për publikime në revista Scopus/WoS.

#### **10.3.5 Përmirësimi i rankimit dhe impaktit**

FSP kontribuon në rankime kryesisht përmes:

- publikimeve të indeksuara,
- citimeve,
- projekteve ndërkombëtare,
- në SDG (çsh. SDG 4-Quality Education, SGD 3 -Well-being, SDG 5- Gender Equality).

#### **10.3.6 Rritja e cilësisë së kërkimit dhe kulturës akademike**

- Trajnime periodike mbi: shkrim shkencor, metodologji, statistikë/analizë, etikë, open science, grant writing.
- Mentorim për studiues të rinj.
- Konferenca/workshope të rregullta të FSP (të paktën 1 aktivitet ndërkombëtar çdo vit).

#### **10.3.7 Sistem meritokratik dhe avancim akademik**

Në përputhje me modelin e UAMD-së:

- Vlerësim i stafit bazuar në publikime, projekte, citime, bashkëpunime, mentorim, ndikim.
- Stiuji: mbulim pagesash APC, mbështetje për konferenca, "seed grants", prioritet në mobilitet

#### **10.4 Mekanizmat kryesorë të zbatimit në FSP**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

**(A) "Research Groups + International Co-authorship"**

- çdo departament të ketë të paktën 1 grup kërkimor aktiv (me plan vjetor).
- çdo grup të ketë 1 (një) partner të huaj
- 

**(B) "Grant Pipeline" (nga ide → aplikim)**

- bankë ide-projektesh,
- kalendar thirrjesh (Erasmus/Horizon/CBHE),
- ekip i vogël mbështetës për aplikime (template, buxhet, logframe).

**(C) Open Science & etikë**

- protokolle për etikën kërkimore,
- menaxhim i të dhënave (FAIR principles),
- repo institucional për punime/raporte (ku është e mundur).

**(D) Lidhja kërkim-mësimdhënie**

- rezultate kërkimore të kthehen në module/mikrokredite;
- Praktika në institucione apo sipërmarrje të shoqërohet me kërkim të aplikueshëm (action research)

**10.5 KPI të matshëm për FSP (2025–2030)**

**Deri në 2027:**

- +50% rritje e publikimeve me bashkëautorsi ndërkombëtare (si target i UAMD, i përkthyer në FSP).
  - minimum 2 grupe kërkimore aktive në fakultet brenda departamenteve ose nderdepartimental.
  - të paktën 1 aplikim në vit në një thirrje ndërkombëtare (Erasmus+/Horizon/CBHE) me FSP si co-applicant.

**Deri në 2030:**

- rritje vjetore e publikimeve në revista të indeksuara (Scopus/WoS) nga stafi i FSP.
- 1 konferencë ndërkombëtare në vit të indeksuar nga Scopus ose çdo 2 vite (të dokumentuar me proceedings/ISBN).
- 60% e stafit të FSP i trajnuar në grant writing, open science, etikë dhe metodologji kërkimi.
- Përfshirje aktive në indikatorë SDG (raporte, projekte, publikime të lidhura me SDG 4).

**10.6 Fazat e zbatimit (të harmonizuara me UAMD)**

**Faza I (2025–2027) – Konsolidimi**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- ngritja e Njesisë së Kërkimit në FSP dhe klasterëve tematikë;
- plan vjetor i trajnimeve + mentorim;
- sistem i thjeshtë i stimujve (konferenca/APC/seed grants);
- standardet e etikës kërkimore dhe data management.

**Faza II (2027–2030) – Zgjerimi**

- rritje e aplikimeve në projekte ndërkombëtare;
- bashkautorësi ndërkombëtare sistematike;
- konferencë ndërkombëtare e përvitshme/bi-vjetore.

**10.7 Monitorimi dhe rezultatet e pritshme**

**Monitorimi** realizohet përmes:

- raportimit vjetor të FSP (publikime, citime, projekte, mobilitet, aktivitete),
- dashboard i thjeshtë KPI për Dekanatin (të integrueshëm me njësinë e raportimit të UAMD),
- vlerësim periodik i grupeve kërkimore (output + impact).

**Rezultatet e pritshme (deri 2030):**

- kulturë kërkimore më aktive dhe e ndërkombëtarizuar në FSP,
- rritje e publikimeve të indeksuara dhe bashkautorësisë,
- rritje e projekteve dhe fondeve,
- ndikim më i matshëm në politikat/praktikat arsimore (p.sh. udhëzues, trajnime, raporte për institucione).

Kërkimi shkencor është themeli mbi të cilin do të ndërtohet reputacioni i FSP-së në të ardhmen. Zhvillimi, sigurimi i fondeve për projekte kërkimore; rritja e cilësisë së kërkimit dhe trajtimi meritokratik i stafit përbëjnë shtyllat kryesore që duhet të plotësohen.

**11. Përfshirja e FSP-së në projekte kërkimore - shkencore**

**11.1. Strategjia dhe Vizioni**

Në përputhje me Strategjinë e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës 2025–2030, Fakulteti i Studimeve Profesionale e konsideron përfshirjen në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni si mekanizëm kryesor për rritjen e cilësisë akademike, ndërkombëtarizimin dhe ndikimin shoqëror.

Vizioni i FSP është të zhvillohet si një njësi akademike lider në projekte kërkimore në fushën e mjekësisë, inxhinierisë, navigacionit, shkencave të aplikuara, menaxhimit në hotelieri turizëm dhe sipërmarrjeve dhe inovacionit, asistencës ligjore dhe administrative, duke integruar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

kërkimin shkencor me mësimdhënien dhe transferimin e njohurive.

### 11.2 Përfshirja në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare

FSP synon rritjen sistematike të pjesëmarrjes në programe si:

- Erasmus+ (Teacher Education, Inclusion, Digital Education)
- Horizon Europe (Society, Education, Digital transformation)
- COST Actions
- EIT HEI initiatives
- projekte kombëtare në menaxhim, inxhinieri, navigacion, shkenca të aplikuara etj.
- projekte me donatorë ndërkombëtarë, Interreg

Fushat prioritare:

- **Digjitalizimi Industrial dhe AI:** Automatizimi i proceseve, aplikimi i inteligjencës artificiale në teknologji dhe navigacion.
- **Teknologjitë e Aplikuara dhe Inxhinieria:** Zhvillime të reja në mekanikë, hidroteknikë, ndërtim, elektrikë, transport, energjitë e rinovueshme etj.
- **Formimi Profesional i Vazhdueshëm:** Certifikime teknike, licenca profesionale dhe trajnime specifike për tregun e punës.
- **Shëndetësia dhe Kujdesi Shëndetësor:** Protokolle moderne në kujdesin shëndetësor, teknika diagnostikuese dhe menaxhim spitalor.
- **Ekonomia Blu dhe Navigacioni:** Siguria detare, logjistika portuale dhe transporti ndërkombëtar, mbrojtja e mjedisit detar (kemi edhe masterin shkencor për këtë MEP&M).
- **Inovacioni në Shërbime dhe Turizëm:** Menaxhim modern i hoteleri-turizmit dhe standarde të reja në shërbime.
- **Standardet Teknike dhe Siguria në Punë:** Politikat e sigurisë industriale, standardet ISO dhe rregulloret ndërkombëtare.
- **Zhvillimi i Kompetencave Praktike:** Mentorimi në laboratorë dhe përditësimi i aftësive të specialistëve të fushës.

Projektet do të lidhen drejtpërdrejt me:

- publikime shkencore
- zhvillim kurrikule
- doktoratura
- ndikim në politika publike

### 11.3 Ndikimi i projekteve në zhvillimin e fakultetit

Përfshirja sistematike e Fakultetit të Studimeve Profesionale në projekte kërkimore-shkencore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

dhe në ekosisteme inovacioni përfaqëson një mekanizëm thelbësor për transformimin institucional dhe rritjen e cilësisë akademike. Projektet kontribuojnë jo vetëm në prodhimin e njohurive të reja, por edhe në modernizimin e proceseve të mësimdhënies, në forcimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe në lidhjen e universitetit me komunitetin dhe tregun e punës.

Në këtë kuadër, ndikimi kryesor i projekteve reflektohet në disa dimensione:

- **Rritja e fondeve kërkimore**, përmes pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve institucionale, duke krijuar burime shtesë për zhvillimin e infrastrukturës, trajnimin e stafit dhe realizimin e aktiviteteve shkencore.
- **Rritja e publikimeve të indeksuara dhe impaktit shkencor**, pasi projektet nxisin prodhimin e rezultateve kërkimore të strukturuar, bashkautorësinë ndërkombëtare dhe citueshmërinë akademike.
- **Ndërkombëtarizimi real i fakultetit**, nëpërmjet rrjeteve kërkimore, projekteve të përbashkëta, mobiliteteve akademike dhe integritit në iniciativa evropiane të inovacionit dhe edukimit.
- **Zgjerimi i mundësive për studentët**, përmes përfshirjes në kërkim, praktikave, projekteve pilot dhe aktiviteteve inovative, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave kërkimore dhe profesionale.
- **Zhvillimi i laboratorëve dhe qendrave kërkimore**, veçanërisht në fushat e edukimit digjital, psikologjisë së edukimit dhe inovacionit pedagogjik, duke përmirësuar kapacitetet infrastrukturore të fakultetit.
- **Modernizimi i kurrikulës**, pasi rezultatet e projekteve integrohen në programet e studimit, metodologjitë e mësimdhënies dhe zhvillimin e kurseve të reja të orientuara drejt kompetencave të shekullit XXI.
- **Rritja e reputacionit institucional**, përmes dukshmërisë ndërkombëtare, pjesëmarrjes në rrjete akademike dhe kontributit në zhvillimin e politikave arsimore dhe inovacionit shoqëror.

Në tërësi, projektet funksionojnë si katalizator për zhvillimin e qëndrueshëm të fakultetit, duke lidhur kërkimin shkencor me mësimdhënien, inovacionin dhe ndikimin shoqëror, dhe duke konsoliduar rolin e Fakultetit të Studimeve Profesionale si një aktor aktiv në hapësirën akademike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Projektet shërbejnë si mekanizëm për transformimin e fakultetit në një njësi kërkimore-inovative.

#### 11.4 Treguesit e suksesit (KPIs)

Për të monitoruar progresin e Fakultetit të Edukimit në përfshirjen në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni, do të përdoren tregues të matshëm që reflektojnë zhvillimin e kapaciteteve kërkimore, ndërkombëtarizimin dhe ndikimin akademik.

Treguesit kryesorë përfshijnë:

- **Rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare me pjesëmarrje të FSP**, duke synuar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

- zgjerimin e rolit të fakultetit nga partner në bashkëdrejtues apo koordinator projektsh.
- **Vlera e fondeve të siguruara nga projekte kërkimore**, si indikator i kapaciteteve institucionale për tërheqjen e financimeve konkurruese dhe zhvillimin e infrastrukturës kërkimore.
  - **Numri dhe cilësia e publikimeve që rrjedhin nga projektet**, veçanërisht në revista të indeksuara ndërkombëtarisht, si dhe rritja e bashkautorësisë ndërkombëtare dhe citimeve.
  - **Përfshirja e studentëve në kërkim**, e matur përmes pjesëmarrjes në projekte, praktikave kërkimore, temave të diplomës dhe aktiviteteve inovative të lidhura me projektet.
  - **Zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare**, përmes marrëveshjeve kërkimore, rrjeteve akademike dhe projekteve të përbashkëta me universitete dhe institucione kërkimore.
  - **Krijimi dhe përmirësimi i laboratorëve dhe qendrave kërkimore**, si tregues i zhvillimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe të kërkimit aplikativ.
  - **Ndikimi i projekteve në zhvillimin e kurrikulës**, përmes kurseve të reja, metodologjive inovative dhe integritit të rezultateve kërkimore në procesin mësimor.
  - **Kontributi në politika publike dhe komunitet**, i matur përmes raporteve, udhëzuesve profesionalë dhe bashkëpunimeve me institucione arsimore dhe organizata.

Këta tregues do të monitorohen në mënyrë periodike dhe do të përdoren për vlerësimin e performancës kërkimore, planifikimin strategjik dhe raportimin institucional.

#### **11.5 Fazat e zbatimit**

Zbatimi i strategjisë për përfshirjen e Fakultetit të Studimeve Profesionale në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni do të realizohet në mënyrë të fazuar, duke siguruar konsolidimin gradual të kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e rolit të fakultetit në hapësirën akademike ndërkombëtare.

##### **Faza I (2025–2027) – Konsolidimi i kapaciteteve**

Në këtë periudhë do të ndërtohen bazat institucionale për pjesëmarrjen në projekte. Do të krijohet një strukturë funksionale për koordinimin e projekteve, dhe do të zhvillohen aplikime pilot në programe kombëtare dhe ndërkombëtare. Paralelisht do të organizohen trajnime për shkrimin e projekteve (grant writing), mentorim për stafin.

##### **Faza II (2027–2030) – Zgjerimi dhe konsolidimi ndërkombëtar**

Në këtë fazë synohet rritja e pjesëmarrjes në projekte të mëdha ndërkombëtare dhe marrja e roleve më aktive në konsorciume kërkimore. Do të forcohet integriti i rezultateve të projekteve në kurrikulë, metodologji mësimore dhe zhvillim profesional të stafit.

Përfshirja e FSP në projekte kërkimore-shkencore përfaqëson një shtyllë thelbësore të planit të zhvillimit të fakultetit. Përmes një qasjeje të integruar që lidh kërkimin, mësimdhënien dhe



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

sipërmarrjen akademike, FSP do të forcojë kapacitetet kërkimore, do të rrisë ndërkombëtarizimin dhe do të kontribuojë në transformimin e universitetit në një aktor inovativ në arsimin e lartë.

## **12. Rrjetëzimi Akademik dhe Potenciali Gjeografik i UAMD**

Fakulteti i Studimeve Profesionale synon të konsolidojë pozicionin e tij në arenën ndërkombëtare përmes përfshirjes aktive në rrjete akademike evropiane dhe globale në fushën e mjekësisë, navigacionit, inxhënerisë, shkencave të aplikuara, menaxhimit etj., në përputhje me orientimin strategjik të Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Përfshirja në rrjete ndëruniversitare forcon identitetin akademik të Fakultetit, rrit vizibilitetin ndërkombëtar dhe krijon mundësi për:

- zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave duale;
- mobilitet të strukturuar të stafit dhe studentëve;
- projekte kërkimore të përbashkëta në fushat përkatëse;
- shkëmbim praktikash të mira pedagogjike;
- ndikim në politika arsimore në nivel rajonal dhe evropian.

### **Strategjia dhe Vizioni**

Qëllimi i Fakultetit të Studimeve Profesionale është të pozicionohet si një njësi akademike aktive dhe e dukshme në rrjetet ndërkombëtare, duke kontribuar në debatet dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e:

- inovacionit teknologjik dhe industrial,
- digjitalizimit të proceseve profesionale (Industry 4.0),
- formimit të specialistëve të lartë,
- kualifikimit profesional të vazhdueshëm (CPE),
- standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë,
- shërbimeve mjekësore dhe kujdesit shëndetësor modern,
- menaxhimit detar dhe logjistikës,
- politikave të zhvillimit ekonomik dhe punësimit,
- standardizimit dhe certifikimit ndërkombëtar (ISO/IMO),
- zhvillimit të qëndrueshëm përmes teknologjive të gjelbra.

Pjesëmarrja aktive në rrjete do të shërbejë si katalizator për:

- rritjen e cilësisë së kurrikulave bazuar në kërkesat e tregut global;
- përmirësimin e kërkimit të aplikuar në shkencat profesionale;
- ndërkombëtarizimin e përmbajtjeve dhe manualeve teknike mësimore;
- krijimin e mundësive për programe të përbashkëta studimi dhe certifikime të dyfishta në afatmesëm.

### **Aktivitetet e Sugjeruara në Nivel Fakulteti**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- Identifikimi i rrjeteve më të përshtatshme për profilin e FSP me qëllim anëtarësimin.
- Hartëzimi i aplikimeve për anëtarësim dhe ndërtimi i materialve të profilit institucional (si psh. statistika, programe, projekte, publikime).
- Përgatitja e stafit akademik dhe studentëve për përfaqësim aktiv në konferenca dhe projekte të rrjeteve.
- Ndërtimi i partneriteteve rajonale për projekte të përbashkëta.
- Zgjerimi i bashkëpunimeve jashtë Evropës

**Përfitimet për FSP:**

- Rritja e vizibilitetit ndërkombëtar dhe reputacionit akademik.
- Mundësi për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe sigurimi i fondeve kërkimore.
- Rritje e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ.
- Transferim i njohurive dhe praktikave të mira nga universitetet më të zhvilluara.
- Zhvillim i programeve të përbashkëta studimi dhe kurrikulave ndërkombëtare.
- Forcim i bashkëpunimit rajonal dhe hapje ndaj tregjeve akademike globale.

**Treguesit e Suksesit (KPIs)**

- Numri i rrjeteve ndërkombëtare ku FSP është anëtar aktiv.
- Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara.
- Numri i projekteve të aplikuara dhe fituara në partneritet.
- Pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në evente ndërkombëtare (konferenca, seminare, trajnime).
- Numri i programeve të përbashkëta studimi të zhvilluara me partnerët ndërkombëtarë.
- Raportet vjetore mbi impaktin e rrjeteve në ndërkombëtarizimin e FSP.

**13. Bashkëpunimi me Diasporën**

Fakulteti i Studimeve Profesionale e konsideron diasporën shqiptare një potencial strategjik për ndërkombëtarizimin e formimit profesionistëve të kualifikuar

. Përfshirja e akademikëve, profesionistëve dhe studentëve të diasporës në jetën akademike të Fakultetit do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, në transferimin e praktikave ndërkombëtare dhe në forcimin e dimensionit global të programeve të studimit.

Në përputhje me orientimin strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti synon të krijojë ura të qëndrueshme bashkëpunimi me diasporën akademike përmes:

- Ftesës së lektorëve dhe studiuesëve të diasporës për cikle leksionesh dhe mentorim;
- përfshirjes së ekspertëve në projekte kërkimore të përbashkëta;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

- organizimit të aktiviteteve akademike me fokus në arsimin dhe identitetin kulturor;
- angazhimit të studentëve të diasporës në programe studimi dhe shkolla verore.

#### Strategjia dhe Vizioni në Nivel Fakulteti

Fakulteti i Studimeve Profesionale synon të shndërrohet në një pikë referimi për bashkëpunimin me diasporën në fushën e edukimit, nëpërmjet:

- shkëmbimit të përvojave pedagogjike ndërkombëtare;
- zhvillimit të projekteve të përbashkëta kërkimore;
- promovimit të identitetit kulturor dhe gjuhësor në kurrikula;

Ky bashkëpunim lidhet drejtpërdrejt me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht me arsimin cilësor dhe partneritetet ndërkombëtare.

#### Integrimi në rrjetet e diasporës akademike

Në nivel fakulteti, masat do të përfshijnë:

- hartëzimin e ekspertizës së diasporës në fushën e programeve të studimit që ofrohen nga FSP (Itali, Gjermani, SHBA, Kanada, Kosovë, Maqedoni e Veriut, etj.);
- organizimin e aktiviteteve akademike me pjesëmarrje të studiuesve të diasporës;
- përfshirjen e stafit dhe studentëve në rrjete ekzistuese akademike të diasporës;
- zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për projekte dhe mobilitete.

#### Indikatorë të përmbledhur:

- numri i lektorëve të diasporës të angazhuar çdo vit;
- numri i aktiviteteve të përbashkëta akademike;
- numri i projekteve ose publikimeve në bashkëpunim me diasporën.

#### 14. Integrimi i Praktikave Profesionale dhe Sistemit të Internship-it: Shtylla e Formimit në Fakultetin e Studimeve Profesionale

Pika më e fortë dhe distinktive që e pozicionon Fakultetin e Studimeve Profesionale (FSP) si një lider në tregun e arsimit të lartë aplikativ, është padyshim **integrimi organik dhe i pandërprerë i praktikës profesionale** në strukturën kurrikulare të programeve të tij. Ndryshe nga modelet tradicionale akademike, ku praktika shihet si një komponent plotësues në fund të ciklit të studimeve, FSP ka implementuar një model inovativ ku studentët angazhohen në laboratorë dhe mjedise reale pune **çdo semestër, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit**. Kjo qasje "learning by doing" (të mësuarit përmes punës) garanton që njohuritë teorike të përfutuara në auditore të testohen, rafinohen dhe konsolidohen menjëherë në terrenin praktik.

Në këtë kuadër, praktika profesionale nuk është thjesht një lëndë, por një proces transformues që fillon që në vitin e parë. Në Departamentet e **Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, Shkencave Mjekësore, Teknologjisë dhe Menaxhimit**, kurrikulat janë konceptuar në mënyrë të tillë që çdo modul teorik të shoqërohet me orët përkatëse të praktikës në laboratorët e specializuar të fakultetit apo në institucionet partnere. Për shembull, studentët e programit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

Navigation dhe Menaxhim Detar ndërveprojnë me simulatorët e lundrimit çdo semester. Ata të Infermierisë, Fizioterapisë, Mamisë dhe Shkencave Teknike Mjekësore nisin ekspozimin në mjediset laboratorike përkatëse, në ambientet e UAMD-së, gjithashtu edhe në spitale dhe në klinika private që në hapat e parë, duke ndërtuar gradualisht besimin dhe kompetencën e nevojshme për të operuar në situata reale dhe me përgjegjësi të lartë.

Strategjia e FSP-së për periudhën 2025–2030 synon të konsolidojë më tej këtë avantazh konkurrues përmes zgjerimit të rrjetit të **internship-eve studentore**. Ky sistem mbështetet në partneritete solide me Autoritetin Portual, qendrat Spitalore Universitare, kompanitë lider të teknologjisë dhe industrinë e shërbimeve. Ky cikël i vazhdueshëm praktik çdo semestër u mundëson studentëve jo vetëm përvetësimin e manualeve teknike dhe përdorimin e pajisjeve të fjalës së fundit, por edhe zhvillimin e "soft skills" të domosdoshme, si: etika në punë, komunikimi ndërprofesional dhe zgjidhja e problemeve në kohë reale. Kjo bën që diplomimi në FSP të mos jetë fundi i një procesi teorik, por certifikimi i një profesionisti që është tashmë i integruar në tregun e punës.

Për më tepër, ky model i praktikës semestrale shërben si një mekanizëm i fuqishëm i **sigurimit të cilësisë**. Përmes feedback-ut të vazhdueshëm që vjen nga tutorët e praktikës në ndërmarrje dhe spitale, Fakulteti përditëson në kohë reale përmbajtjen mësimore, duke siguruar që studentët tanë të jenë gjithmonë në hap me inovacionin global. Ky standardizim i praktikës, i reflektuar në sistemin e krediteve ECTS për çdo semestër, e bën FSP-në një model unik të edukimit profesional në Shqipëri, ku diploma mbart vlerën e përvojës konkrete dhe të matshme.

Në fund, suksesi i këtij modeli konfirmohet nga shkalla e lartë e punësimit të studentëve tanë, të cilët shpesh rekrutohen nga institucionet ku kryejnë internship-et ende pa përfunduar studimet. *Ky është thelbi i vizionit tonë:* një fakultet që nuk prodhon thjesht të diplomuar, por profesionistë të gatshëm për të dhënë kontribut të menjëhershëm në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit.

## 15. Zhvillimi i Masterplanit për një kampus bashkëkohor e modern

### Vizioni

Kampusin e ardhshëm e karakterizojnë tre shtylla kryesore:

➤ *Kampus akademik Cilësor*

- Deri në vitin 2030, kampusi synon të garantojë kushte të përparuara për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, përmes infrastrukturës së re, laboratorëve modernë dhe bibliotekës qendrore digjitale.

➤ *Kampus digjital dhe inovativ*

- Në fazën 2025-2030, synohet të bëhet një kampus digjital përmes implementimit të sistemeve "smart campus" për menaxhimin e shërbimeve akademike dhe administrative.

Në këtë kuadër dhe Fakulteti i Studimeve Profesionale do të mbështetet mbi cilësinë akademike inovacionin, përfshirjen dhe përgjegjësinë sociale.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

### Misioni

Bazuar në misionin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Studimeve Profesionale do të përfshihet në krijimin e një ekosistemi universitar gjithëpërfshirës, inovativ dhe të qëndrueshëm, i cili:

- Mbështet cilësinë akademike; garanton një përvojë të pasur studentore, duke nxitur integrimin social e kulturor të studentëve vendas, të trojeve dhe ndërkombëtarë.
- Digjitalizon shërbimet universitare, ku studentët dhe stafi kanë akses në shërbime akademike, administrative dhe sociale në mënyrë të shpejtë, efikase dhe transparente.
- Forcon ndërveprimin me komunitetin lokal dhe kombëtar, duke shërbyer si një qendër integrimi kulturor, shkencor dhe social për qytetin e Durrësit dhe duke ndërtuar ura bashkëpunimi me rrjete akademike e kërkimore evropiane dhe botërore.

### Objektivat strategjikë

Fakulteti i Studimeve Profesionale është pjesë e rëndësishme e masterplanit të UAMD-së që synon të harmonizojë cilësinë akademike, mirëqenien studentore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe inovacionin.

#### *Objektivat afatmesëm (2025–2030)*

- Modernizimi i infrastrukturës akademike
- Transferimi tek godina e re e Fakultetit të Studimeve Profesionale për të përmbushur standardet bashkëkohore të mësimdhënies.
- Krijimi i laboratorëve shkencorë të specializuar për programet e studimit të ofruara nga ky Fakultet

- Përmirësimi i kushteve të jetës studentore
- Integrimi i shërbimeve sociale dhe mbështetëse për studentët (qendra karriere, shërbime psikologjike, këshillim akademik).

- Digjitalizimi i kampusit
- Implementimi i sistemeve "smart campus" për menaxhimin e orareve, hapësirave dhe shërbimeve universitare.
- Rritja e aksesit në internet me shpejtësi të lartë.

#### *Objektivat afatgjatë (2035–2040)*

- Kampus i integruar dhe i zgjeruar
- Zgjerimi i infrastrukturës për të akomoduar shtimin e programeve studimore dhe popullsisë studentore ndërkombëtare.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- Smart campus i avancuar
- Integrimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të avancuara për menaxhimin e burimeve dhe shërbimeve.
- Automatizimi i plotë i proceseve administrative dhe akademike.

- Diploma tëdyfishta:
- FSP është në pritje të nënshkrimit të marrëveshjes me Fakultetin e Juridikut të Universitetit "Carlo Bò" Urbino, Itali, për programin e përbashkët *Specialist Juridik për Punën dhe Administratën Publike*.

Me këto programe të përbashkëta dhe të tjera krijohet mundësia e bashkëpunimit dhe e kontributit të personaliteteve të specializuar akademike

#### **Faza të zbatimit**

##### **Faza I: Planifikimi dhe prioritetet e hershme (2025 - 2030)**

- Trasferimi dhe mirëmbajtja e godëniës së FSP.
- Vendosja e sistemit fillestar për menaxhim digjital të shërbimeve (platformë "smart campus" faza e parë).

##### **Faza II: Zhvillimi i infrastrukturës bazë (2027–2028)**

- Përparim i ndjeshëm në digjitalizimin e shërbimeve universitare.

##### **Qasje transversale në të gjitha fazat**

- Përfshirja e studentëve dhe stafit në procesin e vendimmarrjes.
- Rishikim i vazhdueshëm i prioritetëve sipas realiteteve ekonomike dhe demografike.

#### **Monitorim dhe vlerësim**

- Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe departamentet e tij janë përgjegjëse për zbatimin në nivel akademik, veçanërisht për laboratorët dhe shërbimet që u përkasin.

##### ➤ Procesi i Monitorimit

- Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe departament raportojnë mbi indikatorët e matjes (KPI).
- Feedback i palëve të interesuara: studentët, stafi akademik dhe komuniteti përfshihen përmes forumeve dhe anketave.

##### ➤ Indikatorët e monitorimit

- Kënaqësia e studentëve dhe stafit matet me anketa periodike (target  $\geq 80\%$  deri në 2030).

#### **Rezultatet e pritshme**

##### ➤ Rezultatet afatmesme (2025–2030)

- Infrastrukturë moderne dhe funksionale duke garantuar mjedise të përshtatshme për mësimdhënie dhe kërkim.
- Rritja e atraktivitetit të universitetit: më shumë studentë nga Shqipëria dhe nga rajoni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

zgjedhin UAMD si destinacion studimi.

➤ *Përfitimet për palët e interesuara*

- Studentët: kushte më të mira mësimi dhe jetese, akses në teknologji, hapësira inovacioni dhe mundësi punësimi.
- Stafi akademik: laboratorë modernë, mbështetje për kërkimin dhe mundësi bashkëpunimi ndërkombëtar.
- Komuniteti lokal: rritje e aktiviteteve kulturore, ekonomike dhe sociale të lidhura me kampusin.

**Impaktet kryesore strategjike**

- Akademik: rritja e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit dhe ndërkombëtarizimit të universitetit.
- Social: përmirësimi i jetës studentore, përfshirja e komunitetit dhe krijimi i një kulture të re akademike.
- Mjedisor: krijimi i një mjedisi të shëndetshëm.

**16. Plani për Digjitalizim**

Laboratorët përdoren si qendra praktike për orët mësimore nga studentët dhe pedagogët për të mundësuar zhvillimin në aftësi teknike dhe jo vetëm, gjë kjo e cila lidhet ngushtë me teknologjitë e reja dhe me metodologjinë më bashkëkohore të nxënësve.

Aktualisht në FSP gjenden: Laboratori i Mekanikës (Kampus G1), Laboratori i Infermierisë dhe Infermierisë Kirurgjikale (Currila), Laboratori i Fizioterapisë (Currila), Laboratori i Mamisë (Currila), Laboratori Navigacionit (Currila), Laboratori i Eficiencës së Energjisë me pajisje të certifikuar, Laboratori i MEP&M me pajisje bashkëkohore për distance learning, për analiza të ujërave etj., Laboratori i Ndërtimit me pajisje për rezistencën e betonit dhe hekurit dhe Laboratori i Fizikës dhe Biologji -Kimi (Currila).




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE



**Çfarë duhet për të ardhmen?**

- Infrastrukturë e avancuar ku përfshin pajisje moderne, rrjet i fuqishëm dhe hapësira për laboratorë bashkëkohor.
- Laboratore digjitale të specializuar për inteligjencë artificiale
- Platforma digjitale për mësim: LMS (learning management system) si Moodle.
- Integrim me cloud: studentët dhe stafi i FSP të kenë mundësi për të aksesuar në distancë në laboratorë dhe materiale nga distanca.



**Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies:**

- Blended Learning: kombinimi i mësimit në klasë dhe online
- Project based learning: studentët punojnë në projekte reale duke përdorur laboratorët ekzistuese por jo vetëm.

**Përfitimet për studentët dhe stafin:**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- Studentëve ju jep mundësi të zhvillojnë aftësi praktike, të përgatiten për tregun e punës, mësojnë më shpejt dhe në mënyrë më interaktive.
- Stafit i mundësohen mjete të avancuara për mësimdhënie, kohë më eficiente si dhe mundësi për të krijuar materiale digjitale që mund të aksesohen në të ardhmen.

**Plan Zhvillimi:** Trajnim i stafit akademik dhe administrativ për përdorimin e teknologjive dhe metodave të reja. Integrimi gradual në kurrikulën ku për çdo lëndë, të ketë elemente digjitale dhe praktike.

**Digjitalizimi i integruar akademik dhe kërkimor- shkencor**

Digjitalizimi si pjesë e strategjisë institucionale synon gjithashtu të lidhet me:

- Krijimin e një Research Repository institucional (Open Science);
- një dashboard digjital për matjen e performancës akademike dhe kërkimore-shkencore.
- sistemet e integruara për ECTS, DS dhe indikatorët e rankimit.

**17. Zhvillimi i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës në harmoni me Strategjinë e Qytetit të Durrësit, Rajonit dhe më gjerë**

Qyteti i Durrësit, si porti më i madh i vendit dhe një nga qendrat më të vjetra urbane të Mesdheut, përbën një hapësirë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, kulturor dhe mjedisor të Shqipërisë. Me pozicionin e tij strategjik në Adriatik, Durrësi po transformohet në një nyje të rëndësishme ndërkombëtare të transportit, turizmit dhe inovacionit. Në këtë kontekst, Fakulteti i Studimeve Profesionale, si një nga njësitë kyçe akademike të UAMD-së, ka një rol të drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional, social dhe kulturor të qytetit të Durrësit, rajonit dhe më gjerë.

- **Nevojat e tregut rajonal** të punës në sektorin e teknologjisë, shëndetësisë dhe shërbimeve
- **Politikat kombëtare** për arsimin dhe formimin profesional e teknik (AFP)
- **Objektivat evropiane** për transformimin digjital dhe inovacionin në shkencat e aplikuara

Fakulteti i Studimeve Profesionale do të veprojë si urë lidhëse midis arsimit të lartë dhe institucioneve detare, qendrave spitalore dhe ndërmarrjeve të prodhimit e teknologjisë. Po kështu FSP do të veprojë dhe si aktor aktiv në zhvillimin e kapitalit njerëzor teknik, vendor dhe rajonal.

**Lidhja me Strategjitë Kombëtare dhe Evropiane**

***Strategjitë Kombëtare të Zhvillimit***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

Plani i Zhvillimit është në përputhje të drejtpërdrejtë me dokumentet strategjike kombëtare të miratuara nga Qeveria Shqiptare, përfshirë:

- Strategjinë kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (SKZHI 2030) – e cila thekson rëndësinë e arsimit, kërkimit dhe inovacionit si baza të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror.
- Strategjinë kombëtare të Arsimit të Lartë 2021-2030, që nxit ndërveprimin universitet-treg pune dhe ndërkombëtarizimin e arsimit.

Në këtë mënyrë, FSP përputhet me prioritetet kombëtare për:

- Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social;
- Rritje të konkurrueshmërisë përmes inovacionit;
- Përmirësim të cilësisë së arsimit dhe punësimit të të rinjve;
- Digjitalizim dhe transformim teknologjik të institucioneve publike.

#### ***Strategjitë dhe Objektivat Evropiane***

Në nivel evropian, FSP e orienton zhvillimin e vet në përputhje me:

- Agjendën Evropiane për Arsimin e Lartë 2030 – që promovon bashkëpunimin ndërkombëtar, digjitalizimin e mësimdhënies dhe zhvillimin e kompetencave për tregun e së ardhmes.
- Programet Horizon Europe dhe Erasmus+ – ku FSP synon rritjen e pjesëmarrjes në konsorciume kërkimore dhe mobilitete ndërkombëtare.

Përmes këtyre lidhjeve strategjike, FSP synon të pozicionohet si një aktor i integruar në hapësirën akademike evropiane dhe si promotor i zbatimit të politikave të Gjelbërta e Dixhitale në Shqipëri.

#### **Roli i Fakultetit në Zhvillimin e Qytetit të Durrësit**

##### **Mbështetja e shërbimeve të industrisë, teknologjisë dhe kujdesit shëndetësor**

Fakulteti do të:

- **Forcojë bashkëpunimin** me ndërmarrjet industriale, portuale dhe kompanitë teknologjike të qytetit.
- **Organizojë trajnime periodike** për specialistët dhe teknikët në shërbim (lifelong learning).
- **Ofrojë module me mikrokredite** për zhvillimin profesional të infermierëve, fizioterapistëve dhe teknikëve të kujdesit shëndetësor.
- **Forcojë bashkëpunimin** me institucionet shëndetësore dhe qendrat diagnostikuese.
- **Forcojë bashkëpunimin** me operatorët e logjistikës detare, agjencitë e navigacionit dhe njësitë e menaxhimit të shërbimeve.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- **Realizojë praktika profesionale** të strukturuar në portin e Durrësit, spitalet rajonale dhe laboratorët e avancuar teknologjikë.

Qëllimi është që Fakulteti të bëhet **qendër referimi për inovacionin teknologjik dhe profesional** në qytet.

**Zhvillimi në harmoni me rajonin: përgjigjja ndaj nevojave rajonale**

- **Nevojë për specialistë të lartë** të kualifikuar në sektorin detar dhe portual.
- **Nevojë për ekspertizë teknike** në mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike dhe industriale.
- **Sfidat e digjitalizimit** të shërbimeve dhe automatizimit të proceseve të punës.
- **Rritjen e kërkesës për shërbime shëndetësore** cilësore, infermieristikë të specializuar, fizioterapi të avancuar.

**Fakulteti i Studimeve Profesionale do të:**

- **Zhvillojë programe specializimi** në menaxhimin e logjistikës dhe sigurisë detare.
- **Forcojë programet në teknologji** të informacionit të aplikuar dhe rrjete komunikimi.
- **Integrojë module mbi inovacionin** në shërbimet mjekësore dhe teknikat e reja diagnostikuese.
- **Zhvillojë kërkime mbi eficiencën** industriale dhe sfidat e zhvillimit ekonomik rajonal.

**Bashkëpunimi me institucionet rajonale**

Fakulteti i Studimeve Profesionale do të formalizojë marrëveshje bashkëpunimi me:

- Spitalin Rajonal Durrës
- Bashkitë e rajonit
- Sipërmarrje private
- Drejtori në Institucione Shtetërore si Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave Shqiptare, Autoritetin Portual, Portin MBM.

Këto bashkëpunime do të mundësojnë:

- Praktika profesionale cilësore
- Projekte të përbashkëta kërkimore
- Studime ndikimi mbi politikat arsimore lokale

**Dimensioni Kombëtar dhe më gjerë: kontributi në reformën arsimore kombëtare**

**Fakulteti i Studimeve Profesionale do të:**

- **Kontribujë në hartimin dhe vlerësimin** e standardeve kombëtare të profesioneve dhe kualifikimeve teknike.
- **Ofrojë ekspertizë** në proceset e reformave të arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe rregulloreve të sigurisë industriale e detare.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE**

- **Bashkëpunojë me Ministritë përkatëse** (Arsimit, Shëndetësisë, Infrastrukturës dhe Ekonomisë) për hartimin e politikave zhvillimore, licencimin e profesioneve dhe trajnimet e specializuara.

#### **Ndërkombëtarizimi në Funkcion të Zhvillimit Lokal**

Ndërkombëtarizimi nuk shihet si qëllim në vetvete, por si mjet për:

- Transferimin e praktikave më të mira evropiane në shkollat shqiptare.
- Zhvillimin e moduleve në gjuhë të huaja.
- Përfshirjen në projekte Erasmus+, Horizon Europe dhe rrjete akademike.
- Rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit.

Përmes këtij dimensionit, Fakulteti do të bëhet aktor rajonal me ndikim ndërkombëtar.

#### **Qëllimet Strategjike të Fakultetit të Studimeve Profesionale**

- **Të shndërrohet në qendër referimi** për zhvillimin profesional të specialistëve teknikë, infermierëve dhe lundëtarëve në rajon.
- **Të kontribuojë aktivisht** në zhvillimin teknologjik, ekonomik dhe shëndetësor të qytetit.
- **Të integrojë kërkimin e aplikuar** me problematikat reale të industrisë dhe tregut të punës.
- **Të ndërtojë partneritete të qëndrueshme** rajonale dhe ndërkombëtare me institucione teknike dhe spitale.
- **Të fuqizojë rolin e studentëve** si profesionistë aktivë dhe kontribues në projektet komunitare e industriale.

#### **Indikatorët e Performancës (KPI)**

| Objektivi                                       | Indikatori                                             | Afati     |
|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Marrëveshje me industrinë &amp; biznesin</b> | $\geq 25$ marrëveshje aktive (Porti, Spitale, IT)      | 2027      |
| <b>Trajnime &amp; Certifikime profesionale</b>  | $\geq 12$ module trajnimi/vit për specialistët         | 2026–2030 |
| <b>Projekte teknike/komunitare</b>              | $\geq 6$ projekte/vit (shëndetësi, mjedis, teknologji) | 2026      |
| <b>Kërkime të aplikuara të publikuara</b>       | $\geq 4$ studime/vit mbi efencën dhe inovacionin       | 2028      |
| <b>Partneritete ndërkombëtare aktive</b>        | $\geq 7$ marrëveshje për mobilitete & joint-degrees    | 2030      |

#### **Ndikimi i Pritur**

Përmes këtij orientimi strategjik, Fakulteti i Studimeve Profesionale do të:

- **Rrisë cilësinë teknike dhe profesionale** të fuqisë punëtore në qytet dhe rajon.
- **Ndihmojë në zhvillimin e kapitalit njerëzor** të kualifikuar për industritë prioritare.
- **Forcojë lidhjen simbiotike** midis universitetit, sipërmarrjes dhe institucioneve publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE

- Kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik, mjedisor dhe shëndetësor.

#### Dimensioni Profesional dhe Inovativ

##### Objektivat:

- **2028:** Themelimi i Qendrës së Ekselencës për Trajnime Profesionale dhe Certifikime Ndërkombëtare.
- **2030:** Zhvillimi i programeve të orientimit drejt profesioneve teknike për shkollat e mesme profesionale.
- **2040:** UAMD të bëhet model kombëtar për arsimin e lartë profesional dhe urën lidhëse me industrinë 4.0.

#### Ndërkombëtaritimi dhe Rrjetëzimi Rajonal

##### Objektivat:

- **2030:** Dyfishimi i mobiliteteve Erasmus+ për praktika pune (traineeships) jashtë vendit.
- **2035:** Nënshkrimi i programeve të përbashkëta Master Profesional ose Certifikime të Dyfishta me akademi detare dhe teknike evropiane.

##### Indikatorët e Suksesit

- **85% e të diplomuarve** të punësuar në sektorët përkatëse (porte, spitale, industri, IT) brenda 6 muajve nga diplomimi deri në vitin 2030.
- **Rritje me 50%** e projekteve të kërkimit të aplikuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë industrialë.
- **100% e laboratorëve të fakultetit** të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë.

Ky plan përbën një vizion afatgjatë për integrimin e FSP-së në strukturën zhvillimore dhe ekonomike të qytetit dhe rajonit. Ai forcon lidhjen midis dijes teknike, inovacionit laboratorik dhe praktikës në terren, duke e shndërruar fakultetin në një aktor kyç të zhvillimit rajonal, industrial dhe profesional.

FSP do të jetë një fakultet modern, teknologjikisht i avancuar, ndërkombëtar dhe i hapur, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe brezave të ardhshëm të specialistëve në Durrës.